**LIGJI Nr. 05/L - 085**

## PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

## LIGJ PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

## KAPITULLI I
## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë rregulla dhe masa për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të saj.

2. Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën Nr. 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

### Neni 2
### Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji përfshin rregullat e përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar të energjisë elektrike, si pjesë e tregut rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, si dhe përcakton rregullat që kanë të bëjnë me qasjen e palëve në rrjet, obligimet për shërbime publike, të drejtat e konsumatorëve dhe kushtet e konkurrencës.

### Neni 3
### Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Balancimi mes furnizimit dhe kërkesës -** përmbushja e kërkesës së parashikueshme të konsumatorëve për energji elektrike, pa pasur nevojë për zbatimin e masave për zvogëlimin e konsumit;

1.2. **Balancimi -** është tërësia e proceseve, nëpërmjet të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të

qëndrueshmërisë së tij;

1.3**. Përgjegjësia e balancimit -** obligimi i pjesëmarrësve të tregut që të balancojnë gjenerimin, konsumin, blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, në pajtim me oraret e pranuara, dhe të qenit financiarisht përgjegjës për jobalancet e shkaktuara;

1.4. **Pala përgjegjëse e balancimit -** pjesëmarrësi i tregut ose përfaqësues i zgjedhur i tij si përgjegjës për jobalancim;

1.5. **Barazimi përfundimtar -** emërtim i përbashkët për proceset e përdorura për përcaktimin e shfrytëzimit të sistemit të transmetimit nga çdo palë, detyrimet financiare dhe pagesat që rrjedhin nga këto detyrime, si dhe detyrimet e palëve për jobalncet e shkaktuara;

1.6. **Burim i energjisë së ripërtërishme -** burim i ripërtërishëm, jofosil i energjisë si: energjia e erës, energjia diellit, energjia gjeotermale, energjia e ujit, energjia e valëve, biomasa, gaz i mbetjeve urbane, gaz i mbetjeve të trajtimit të ujërave dhe biogazi; siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së ripërtërishme;

1.7. **Burim rezervë -** është një burim dytësor i furnizimit me energji elektrike, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergjetik;

1.8. **Certifikata e origjinës -** dokument i formës elektronike, që lëshohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që ka funksionin e shitjes, me qëllim të ofrimit si provë te konsumatori fundor së një pjesë e caktuar e energjisë është prodhuar nga burime të energjisë së ripërtërishme;

1.9. **Dispeçimi -** menaxhim i rrjedhave të energjisë elektrike në rrjet në mënyrë që furnizimi dhe kërkesa për energji elektrike të jenë në balancë;

1.10. **Derivativat e energjisë elektrike -** instrumentet financiare, siç janë: opsionet, mundësitë në të ardhmen, këmbimet, marrëveshjet e normave të përcjelljes, dhe të gjitha kontratat tjera derivative, në rastet kur ky instrument ka të bëjë me energjinë elektrike;

1.11. **Derivativ elektrik -** është një instrument financiar që mund të përdoret nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike si mjet sigurie ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg;

1.12. **Energjia e balancimit -** energji e aktivizuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të vënë në funksion sistemin e balancimit;

1.13. **Efiçienca e energjisë/menaxhimi i kërkesës -** qasje globale apo e integruar që ka për synim të ndikojë në konsumin e energjisë, si nga aspekti i kohës së shfrytëzimit ashtu edhe nga aspekti i sasisë së shfrytëzimit, me qëllim të reduktimit të konsumit të energjisë primare dhe ngarkesës së pikut, duke iu dhënë përparësi investimeve në masat e efiçencës së energjisë, ose masave tjera siç janë: kontrata e furnizimit me ndërprerje, mbi investimet për të rritur kapacitetet e gjenerimit, nëse ky është një opsion më ekonomik dhe efikas, duke pasur në konsideratë ndikimet pozitive në mjedis, si pasojë e reduktimit të konsumit të energjisë, si dhe në sigurinë e furnizimit dhe aspektet e kostos së shpërndarjes të lidhura me këtë;

1.14. **Eksport i deklaruar -** dispeçimi i energjisë elektrike që livrohet njëkohësisht në një Palë Kontraktuese apo një vend të tretë si import i deklaruar, në bazë të një marrëveshjeje kontraktuale;

1.15. **Forcë madhore -** është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm;

1.16. **Furnizues -** ndërmarrjen e energjisë të licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit;

1.17. **Furnizim -** shitjen, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te konsumatorët;

1.18. **Furnizim i garantuar -** furnizimi i përkohshëm i konsumatorit fundor, të cilit, në raste të përcaktuara në këtë ligj, i mundësohet furnizimi i përkohshëm me kufizimet e përcaktuara në këtë ligj;

1.19. **Furnizues i mundësisë së fundit -** është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj konsumatorëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre;

1.20. **Interkonektor -** linja e transmetimit që kalon apo përshkon kufirin ndërmjet Kosovës dhe të Palëve Kontraktuese dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të Palëve Kontraktuese;

1.21. **I licencuar -** është një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.22**. Import i deklaruar -** pranimi i energjisë elektrike nga një Palë Kontraktuese apo një vend i tretë, njëkohësisht me dispeçimin e energjisë elektrike (eksporti i deklaruar) nga një Palë Kontraktuese tjetër;

1.23. **Kapacitet i balancimit -** kapaciteti rezervë i kontraktuar;

1.24. **Kongjestion -** situata kur një interkoneksion që lidh sistemet shtetërore të transmetimit nuk mund të përballojë të gjitha rrjedhat fizike të energjisë që rezultojnë nga tregtimet ndërkufitare të kërkuara nga pjesëmarrësit në treg, për shkak të mungesës së kapacitetit interkonektiv dhe/ose shtetëror të sistemeve transmetuese në fjalë;

1.25. **Konsumator -** blerës me shumicë ose konsumator fundor i energjisë elektrike;

1.26. **Konsumator fundor -** konsumatorin e energjisë elektrike që blenë energjinë elektrike për përdorimin vetanak;

1.27. **Konsumator familjar -** konsumator i energjisë elektrike që blen energji elektrike

për konsum vetanak për ekonominë e vet familjare, duke mos përfshirë veprimtaritë komerciale apo profesionale. Për objektet që shërbejnë për qëllime fetare aplikohen tarifat e konsumatorve familjar;

1.28. **Konsumator jofamiljar -** person fizik a juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë;

1.29. **Konsumator në nevojë -** është një konsumator familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

1.30. **Kodi i rrjetit të transmetimit -** përmbledhje e normave dhe rregullave teknike lidhur me sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit;

1.31. **Kodi i rrjetit të shpërndarjes -** tërësia e rregullave teknike dhe procedurave për operimin, mirëmbajtjen, planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e tij;

1.32. **Kodi i Transmetimit -** është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO **-** E;

1.33. **Kodi i Matjes -** është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike;

1.34. **Konsumator me shumicë (tregtar) -** personi fizik ose juridik që blenë energji elektrike me qëllim të rishitjes brenda apo jashtë sistemit në të cilin është themeluar;

1.35. **Kontroll -** të drejtat, kontratat apo mjetet tjera të cilat, ndaras apo në kombinim dhe duke marrë parasysh faktet ose ligjin përkatës, ofrojnë mundësi për të ushtruar ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje të caktuar, veçanërisht mbi pikat në vijim:

1.35.1. pronësia apo e drejta për të shfrytëzuar të gjitha asetet e një ndërmarrje apo një pjese të tyre;

1.35.2. të drejtat apo kontratat të cilat bartin ndikim vendimtar mbi kompozicionin, votimin apo vendimet e organeve të një ndërmarrje.

1.36. **Kontrata e furnizimit me energji elektrike -** kontrata për furnizimin me energji elektrike, por nuk përfshin derivativat e energjisë elektrike;

1.37. **Kontrata e furnizimit -** është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivativët e energjisë elektrike;

1.38. **Kontratë e plotë furnizimi -** është kontrata e furnizimit, e cila përfshin përgjegjësitë e përdorimit të rrjetit të transmetimit ose shpërndarjes;

1.39. **Kontrata e furnizimit me ndërprerje -** është kontrata e furnizimit, e cila i jep të drejtën Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të ndërpresë përkohësisht furnizimin me energji elektrike të klientit fundor, në përputhje me kushtet e shërbimit, të përcaktuara në Kodet e Rrjetit dhe aktet e tjera rregullatore;

1.40. **Linja direkte -** linja e energjisë eklektike që lidhë një prodhues të veçuar me një konsumator të veçuar ose një linjë që lidh një prodhues të energjisë elektrike me një ndërmarrje të furnizimit me energji elektrike me qëllim që t'i ofrojë furnizim direkt kësaj ndërmarrjeje, filialeve dhe konsumatorëve të saj;

1.41. **Licencë -** është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.42. **Matës inteligjent -** është një pajisje elektronike që regjistron në kohë reale të dhënat e konsumit të energjisë elektrike dhe komunikon këtë informacion, të paktën çdo ditë, tek operatori i sistemit për qëllime të monitorimit dhe të faturimit;

1.43. **Ministria -** është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë;

1.44. **Modeli i tregut të energjisë elektrike -** është një dokument i përgatitur dhe i miratuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të energjisë elektrike;

1.45. **Ndërmarrje e integruar vertikalisht -** ndërmarrjen e energjisë elektrike apo grupin e ndërmarrjeve të energjisë elektrike, ku i njëjti person ose persona autorizohen për të ushtruar kontroll direkt ose indirekt, dhe kur ndërmarrja ose grupi i ndërmarrjeve kryejnë së paku një nga funksionet e transmetimit ose distribucionit dhe së paku një nga funksionet e prodhimit ose furnizimit;

1.46. **Ndërmarrje e energjisë elektrike -** personi fizik apo juridik që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërlidhen me veprimtaritë e cekura, por nuk përfshinë konsumatorin final;

1.47. **Ofrues i shërbimit të balancimit -** është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, që ofron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, në bazë të një kontrate për pjesëmarrje në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të sistemit elektrik;

1.48. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes -** personi fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;

1.49. **Operator i Tregut -** personi fizik ose juridik, i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe është përgjegjës për të operuar dhe organizuar tregun e energjisë elektrike në Kosovë;

1.50. **Operimi i tregut -** është veprimtaria që kryen operatori i tregut lidhur me

menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut;

1.51. **Obligime të shërbimit publik -** obligim që i imponohet një ndërmarrjeje të energjisë elektrike sipas ligjit ose sipas një vendimi të aprovuar nga Qeveria ose Zyra e Rregullatorit për Energji varësisht nga fushat e përgjegjësisë se tyre mund të vendosin obligime që mund të lidhet me sigurinë e furnizimit me energji elektrike, rregullshmërinë, kualitetin dhe çmimet e furnizimit, efiçencën e energjisë, energjinë nga burimet e energjisë së ripërtërishme si dhe mbrojtjen mjedisore dhe klimatike, por që nuk krijon diskriminim dhe nuk dëmton konkurrencën përtej masës së domosdoshme për arritjen e qëllimit për të cilin imponohet shërbimi publik në fjalë;

1.52. **Operator i Sistemit të Transmetimit -** personi fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;

1.53. **Përparësia ekonomike -** renditja e burimeve të energjisë elektrike, në pajtim me kriteret ekonomike;

1.54. **Prodhim -** prodhimi i energjisë elektrike;

1.55. **Prodhimi i energjisë -** është procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime primare të energjisë;

1.56. **Prodhues -** personi fizik ose juridik që prodhon energjinë elektrike;

1.57. **Prodhues i lidhur në shpërndarje -** është një prodhues, centrali i të cilit është i lidhur në sistemin e shpërndarjes;

1.58. **Pajisjet e matjes -** instrumente të regjistruara në regjistrin e pajisjeve matëse të certifikuara në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar;

1.59. **Planifikim afatgjatë -** planifikimin e nevojave për investime në kapacitetet e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes në bazë afatgjatë me synim të plotësimit të kërkesave të sistemit për energji elektrike dhe sigurimin e furnizimit të konsumatorëve;

1.60. **Rrjedha ndërkufitare -** rrjedha fizike e energjisë elektrike në rrjetin transmetues të Kosovës si pasojë e aktiviteteve të prodhuesve dhe/ose konsumatorëve jashtë kufijve të Kosovës;

1.61. **Rregullat e Tregut -** normat të cilat rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve në tregun e energjisë elektrike, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të transmetimit me qëllim të mirëmbajtjes së balancit fizik të tregut;

1.62. **Sistemi i shpërndarjes -** kombinim i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve të energjisë elektrike me tension të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen

e energjisë elektrike;

1.63. **Sistem i mbyllur i shpërndarjes -** sistem i shpërndarjes së energjisë elektrike, brenda një zone gjeografike në të cilën aktivitete industriale, komerciale dhe të shërbimeve janë të koncentruar, por që këtu nuk përfshihen konsumatorët familjar nëse:

1.63.1. për arsye specifike teknike ose të sigurisë, operacionet e procesit të prodhimit të përdoruesve të atij sistemi janë të integruara;

1.63.2. ai sistem shpërndanë energjinë elektrike kryesisht tek pronari ose operatori i sistemit ose tek ndërmarrjet vartëse.

1.64. **Sistem interkonektiv -** një numër i sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të ndërlidhura mes vete përmes një ose më shumë interkonektorëve;

1.65. **Siguria e operimit të rrjetit -** operimi i vazhdueshëm dhe në çfarëdo rrethane i sistemit të transmetimit dhe, sipas nevojës, sistemit të shpërndarjes;

1.66. **Siguria -** furnizimi i sigurt i energjisë elektrike dhe ofrimi i sigurisë teknike;

1.67. **Siguria e furnizimit të energjisë elektrike -** mundësia e sistemeve të energjisë elektrike për të furnizuar konsumatorët fundorë me energji elektrike, në pajtim me këtë ligj;

1.68. **Sistemi i transmetimit -** sistemi i përbërë nga kombinimi i linjave, nënstacioneve dhe stabilimenteve të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike;

1.69. **Shërbimet ndihmëse -** të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes;

1.70. **Shërbimi i balancimit -** është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin;

1.71. **Shpërndarja -** transportim i energjisë elektrike, përmes sistemeve të shpërndarjes, me qëllim të dërgimit të saj deri tek konsumatori, por duke mos përfshirë furnizimin;

1.72. **Shërbimi universal i furnizimit -** e drejta e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve ekonomike që punësojnë jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës dhe që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro që të furnizohen me energji elektrike të një kualiteti të caktuar me çmim të arsyeshëm, qartësisht të krahasueshëm, transparent dhe jo diskriminues;

1.73. **Shfrytëzuesi i sistemit -** personat fizikë dhe juridikë të cilët furnizojnë apo furnizohen përmes sistemit të transmetimit ose shpërndarjes;

1.74. **Transit i deklaruar -** një rrethanë kur ndodhë një eksport i deklaruar i energjisë elektrike dhe ku rruga e nominuar për transaksion përfshin një shtet në të cilin nuk do

të realizohet as dërgimi dhe as pranimi korrespondues i energjisë elektrike;

1.75. **Transmetim -** transportimin i energjisë elektrike, përmes sistemeve të tensionit të lartë dhe sistemeve të interkonektuara të tensionit të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundorë apo tek operatorët e sistemit të shpërndarjes, por pa përfshirë furnizimin;

1.76. **Treg i organizuar i energjisë elektrike -** treg i organizuar në mënyrë institucionale një ditë para livrimit fizik dhe/ose gjatë ditës së livrimit fizik. Pjesëmarrësit në treg paraqesin ofertat dhe kërkesat e tyre për produkte të paracaktuara dhe të standardizuara të energjisë elektrike për çdo interval kohor një ditë para, ose gjatë ditës së livrimit fizik;

1.77. **Ndërmarrje e Ndërvarur (të përzierë) -** dy ose më shumë ndërmarrje me detyrim që të përpilojë pasqyrat financiare dhe raportet vjetore të konsoliduara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.78. **Prodhues i Kualifikuar -** një ndërmarrje e energjisë dhe / ose personi tjetër juridik apo fizik që prodhon energji nga burime të ripërtërishme ose njëkohësisht prodhon energji elektrike dhe energji termike në një mënyrë shumë efikase, në një impiant të veçantë prodhues duke përdor mbeturina apo burime të ripërtërishme të energjisë në një mënyrë ekonomikisht të qëndrueshme në përputhje me mbrojtjen e mjedisit;

1.79. **Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejmë: Rregullatori) -** është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

2. Termat tjerë të përdorur në këtë ligj kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

**Neni 4**
**Veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike**

1. Veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike sipas këtij ligji janë:

1.1. prodhimi i energjisë elektrike;

1.2. transmetimi i energjisë elektrike;

1.3. shpërndarja e energjisë elektrike;

1.4. organizimi i tregut të energjisë elektrike;

1.5. furnizimi me energji elektrike;

1.6. furnizimi me shumicë i energjisë elektrike (tregtimi).

2. Për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, sipas paragrafit 1. të këtij neni, ndërmarrjet e energjisë duhet të kenë licencë të lëshuar nga Rregullatori, përveç përjashtimeve që përcaktohen sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

3. Për të mundësuar ushtrimin e veprimtarive të gjitha stabilimentet elektrike, të kyçura me sistemin e transmetimit apo sistemin e shpërndarjes në Kosovë, duhet të operojnë brenda një sistemi unik të energjisë elektrike me funksion të përbashkët e të vazhdueshëm për të prodhuar, transmetuar, shpërndarë dhe furnizuar me energji elektrike në mënyrë të koordinuar.

4. Për të mundësuar ushtrimin  e veprimtarive sistemi i energjisë elektrike në Kosovë duhet të operojë në mënyrë të koordinuar dhe mund të lidhet me sistemet e energjisë elektrike të vendeve të tjera në tregun rajonal të energjisë elektrike dhe me sistemet e energjisë elektrike të shteteve tjera, në pajtim me Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

**Neni 5**
**Kushtet për caktimin e obligimeve të shërbimit publik**

1. Rregullatori ose Qeveria varësisht nga fushat e përgjegjësisë së tyre mund të vendosin obligime të shërbimit publik për ndërmarrjet e energjisë, në bazë të interesit publik dhe në interes të përgjithshëm ekonomik, të cilat kanë të bëjnë me:

1.1. sigurinë, duke përfshirë sigurinë e furnizimit;

1.2. rregullsinë;

1.3. cilësinë dhe çmimin e furnizimit;

1.4. mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e konkurrencës, duke përfshirë efiçiencën e energjisë, energjinë nga burimet e ripërtërishme dhe ndryshimet klimatike.

2. Çdo obligim për shërbimin publik i ngarkuar  nga Qeveria ose Rregullatori varësisht nga fushat e përgjegjësisë së tyre duhet të përfshihet në licencën përkatëse të ndërmarrjes së energjisë elektrike, pa vonesë, pas procedurës së lëshimit të licencës së re apo modifikimit të licencës aktuale.

3. Obligimet e shërbimit publik, të vendosura sipas këtij ligji, duhet të përkufizohen qartësisht, të jenë transparente, jodiskriminuese, të verifikueshme, si dhe duhet të garantojnë barazinë e qasjes për ndërmarrje të energjisë elektrike te konsumatorët vendorë. Për më tepër, vendosja e obligimeve të shërbimit publik si dhe zbatimi i tyre nga ndërmarrjet e energjisë duhet të bëhen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, duke mos penguar hapjen e tregut.

4. Për të përmbushur kriterin e transparencës, Rregullatori miraton masat e veçanta për vendosjen e obligimeve të shërbimit publik në një formë të vendimit të publikuar dhe obligimet e tilla do të përfshihen nga Rregullatori në licencën e ndërmarrjes së energjisë elektrike.

5. Vendimet për vendosjen e obligimit të shërbimit publik ndaj një ndërmarrje të energjisë duhet të:

5.1. përcaktojnë në mënyrë të qartë obligimin e tillë, duke rregulluar, por pa u kufizuar në: obligimin për të ofruar furnizim konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit si shërbim universal, sigurimin e pandërprerë të furnizimit me energji, sigurimin e trajtimit të barabartë të konsumatorëve, sigurimin e funksionimit të sistemit të furnizimit në nivel shtetëror me energji elektrike me koston më të ulët të mundshme;

5.2. specifikojnë natyrën e të drejtave ekskluzive apo të veçanta që i jepen ndërmarrjes së tillë;

5.3. definojnë territorin dhe periudhën për të cilën vendoset obligimi i shërbimit publik;

5.4. qartësojnë financimin dhe kriteret për kalkulimin e kompensimit që do të fitohet nga ndërmarrjet që kanë marrë përsipër obligimin e shërbimit publik.

6. Kur vendos obligimin e shërbimit publik, Qeveria ose Rregullatori varësisht nga fushat e përgjegjësisë së tyre duhet të provojë në një vlerësim të publikuar ndikimi që kjo masë është më së paku kufizuese, si dhe masë që është proporcionale dhe e domosdoshme për sigurimin e ofrimit të shërbimit publik.

7. Imponimi i obligimeve të shërbimit publik nuk duhet të shkaktojë diskriminim ndërmjet ndërmarrjeve në Komunitetin e Energjisë.

8. Kompensimi financiar, format tjera të kompensimit dhe të drejtat e veçanta që i jepen ndërmarrjeve të energjisë për ofrimin e shërbimit publik do të bëhen në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Shpenzimet e bëra nga të licencuarit për ofrimin e shërbimit publik do të njihen si të arsyetuara me rastin e miratimit nga Rregullatori, të tarifave për shërbime të ofruara në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

9. Rregullatori përcakton ndarjen e shpenzimeve të obligimeve të shërbimit publik të vendosura sipas këtij neni tek konsumatorët fundorë në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Kompensimi për këto shpenzime nuk mund të tejkalojë shpenzimet e bëra në ushtrimin e obligimeve të shërbimit publik minus të ardhurat e fituara nga ofrimi i shërbimit. Kompensimi mund të përfshijë edhe një fitim të arsyeshëm. Secili kompensim për të licencuarit për obligimin e shërbimit publik duhet t'i nënshtrohen vlerësimit sipas rregullave të Komunitetit të Energjisë për Ndihmën Shtetërore.

10. Asnjë i licencuar nuk mund të obligohet të ndërtojë rrjetin në një zonë në të cilën nuk ka rrjet në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç nëse kërkohet për integrim të prodhuesve të rinj të energjisë së ripërtërishme me prioritet, si dhe në bazë të rregullave të miratuara nga Rregullatori që rregullojnë ndarjen transparente e jodiskriminuese të shpenzimeve plotësuese mes atyre shfrytëzuesve të rrjetit që kërkojnë shërbime të tilla si dhe shfrytëzuesve ekzistues të rrjetit të të licencuarit. Kjo nuk paragjykon obligimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që të lidhë blerësit fundorë në rrjetin e tij në bazë të afateve, kushteve e tarifave të përcaktuara nga Rregullatori në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

11. Në ushtrimin e aktiviteteve të tyre, të licencuarit që i nënshtrohen obligimeve të shërbimit publik do të respektojnë ato obligime, si dhe ofrimi i shërbimeve të tilla do të monitorohet nga Rregullatori.

12. Qeveria ose Rregullatori, varësisht nga fushat e përgjegjësisë se tyre pas vendosjes së obligimit të shërbimit publik në licencat e ndërmarrjeve elektrike, informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për të gjitha masat e miratuara për të përmbushur obligimet e shërbimit publik, duke përfshirë efektin e tyre të mundshëm në konkurrencën në nivel shtetëror ose ndërkombëtarë.

13. Rregullatori informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë çdo dy (2) vjet për ndonjë ndryshim të masave të tilla.

## KAPITULLI II
## PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

### Neni 6
### Prodhimi i energjisë elektrike

1. Veprimtaria e prodhimit ushtrohet nga ndërmarrjet e energjisë elektrike, të licencuara nga Rregullatori, për prodhim të energjisë elektrike, apo nga persona fizikë ose juridikë të cilët janë të liruar nga detyrimi për t'u pajisur me licencë, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

2. Prodhuesit e energjisë elektrike të cilët kanë licencë për prodhimin e energjisë elektrike mund të prodhojnë energji elektrike në regjim pune bazë apo regjim variabil, përfshirë energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes, energjinë për balancim të sistemit dhe energjisë për shërbime ndihmëse.

### Neni 7
### Obligimet dhe të drejtat e prodhuesve të energjisë elektrike

1. Prodhuesit e energjisë elektrike janë të obliguar:

1.1. t'iu përmbahen të gjitha kushteve të përcaktuara në licencë për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit, nëse një licencë e tillë kërkohet;

1.2. t'iu ofrojë kapacitetin e tyre në mënyrë transparente, jodikriminuese dhe të bazuar në treg të gjithë konsumatorëve në tregje me shumicë dhe pakicë duke përfshirë edhe atyre me obligime të shërbimit publik;

1.3. t'i plotësojë të gjitha kërkesat teknike dhe operative dhe në veçanti t'iu përmbahen kushteve nga Kodi i rrjetit të transmetimit dhe Kodi i rrjetit të shpërndarjes dhe rregullave të përcaktuara në rregullore dhe standarde teknike të zbatueshme;

1.4. të veprojë në pajtim me rregullat e konkurrencës, kur merr pjesë në tregun e energjisë elektrike;

1.5. t'i mirëmbajë stabilimentet prodhuese në gjendje që të garantojë sigurinë dhe gatishmërinë e tyre operative në përputhje me rregullat dhe standardet teknike;

1.6. t'i ofrojë Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes shërbimet ndihmëse dhe të balancimit, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike në përputhje me parametrat dinamikë të Kodit të rrjetit të transmetimit, Kodit të rrjetit të shpërndarjes dhe rregullave të organizimit të tregut të energjisë elektrike si dhe të nënshkruajë kontrata sipas marrëveshjeve të arritura për raste të tilla dhe bazuar në ato kontrata të aktivizojë stabilimentet prodhuese me kërkesë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me qëllim të ofrimit të shërbimeve ndihmëse dhe atyre të balancimit;

1.7. t'i ofrojë Operatorit të Sistemit të Transmetimit kapacitetet e prodhimit në dispozicion për nevoja të operimit të sistemit, sigurisë së sistemit dhe balancimit të sistemit;

1.8. të veprojnë në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit për të siguruar kontroll të përhershëm mbi ndikimin në mjedis;

1.9. të pajiset me pajisje matëse adekuate për matjen e energjisë elektrike që hyn në sistem;

1.10. t'iu përmbahen të gjitha obligimeve tjera që mund të rezultojnë nga zbatimi i këtij ligji si dhe ligjeve, rregulloreve, rregullave dhe kodeve të ndërlidhura;

1.11. në rastet kur së paku një nga asetet e prodhimit ka kapacitet të instaluar prej më shumë se pesë (5) MW, duhet t'i mbajë të dhënat për çdo orë gjatë funksionimit të centralit të tij, për një periudhë pesë (5) vjeçare, në mënyrë që të verifikohen të gjitha vendimet operative të dispeçimit dhe trendët ofertuese në këmbimet e energjisë, ankandet e interkonektorëve, tregjeve të rezervave dhe tregjeve të letrave me vlerë, të cilat duhet t'ia vë në dispozicion Rregullatorit, Autoritetit Kosovar për Konkurrencë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ose organizatave tjera ndërkombëtare që janë themeluar, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo aktet juridike ndërkombëtare që janë të obligueshme për Kosovën dhe që kanë mandat për të kryer funksione të tilla. Informatat që duhet ruajtur për orë/për central, duhet të përfshijnë, por pa u kufizuar, të dhënat mbi kapacitetet prodhuese në dispozicion dhe rezervat e dedikuara, përfshirë alokimin e këtyre rezervave të dedikuara në nivel të centralit në kohën e kryerjes së ofertimit dhe gjatë realizimit të prodhimit;

1.12. deri në masën e nevojshme për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, Rregullatori mund të imponojë obligime të shërbimit publik për prodhuesit që të shesin energjinë me kushte të rregulluara për furnizues me obligime të shërbimit publik, në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji. Vendimi i Rregullatorit duhet publikuar dhe dërguar në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë;

1.13. Rregullatori mund të kërkojë nga prodhuesit që të shesin një pjesë të kapacitetit të tyre në tregun e organizuar të energjisë elektrike.

2. Prodhuesit e energjisë elektrike, me kusht që t'i përmbahen dispozitave të këtij Ligji, Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, licencave, kodeve dhe rregullave tjera relevante, të cilat miratohen nga Rregullatori, kanë të drejtë të:

2.1. shfrytëzojnë burimet e energjisë që i konsiderojnë më të përshtatshme për procesin e prodhimit në centralin elektrik të tyre, me kusht që shfrytëzimi i burimeve në fjalë të jetë në përputhje me të gjitha kushtet relevante teknike, mjedisore dhe të efiçiencës së energjisë;

2.2. lidhin centralet e tyre me sistemin e transmetimit apo sistemin e shpërndarjes në pajtim me kushtet dhe rregullat përkatëse;

2.3. shesin energjinë elektrike sipas dispozitave të këtij ligji akteve tjera dhe në veçanti Rregullave të Tregut;

2.4. blejnë energjinë elektrike për nevoja të veta;

2.5. kenë qasje në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes sipas rregullave dhe kushteve përkatëse;

2.6. faturojnë dhe inkasojnë pagesat, sipas kontratave të nënshkruara për të gjitha shitjet e energjisë elektrike, kapacitetet, shërbimet ndihmëse dhe shërbimeve tjera të kontraktuara.

3. Prodhuesi i energjisë elektrike duhet të përpilojë një program të masave që duhet të ndërmerr me qëllim të ngritjes së efiçincës së prodhimit dhe të raportojë në baza vjetore tek Rregullatori.

4. Prodhuesit e kyçur në rrjetin e transmetimit apo në rrjetin e shpërndarjes duhet të jenë të përgatitur teknikisht në mënyrë që të plotësojnë kushtet teknike për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për operatorët në fjalë sipas parimeve të Kodit të rrjetit të transmetimit dhe Kodit të rrjetit të shpërndarjes.

**Neni 8**

**Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimi**

1. Ndërmarrjet e energjisë që prodhojnë energji elektrike duke shfrytëzuar burimet e ripërtërishme të energjisë, apo që prodhojnë energji në formën e bashkëprodhimit, kanë të drejtë të pajisen me certifikatë të origjinës, që lëshohet nga Rregullatori dhe mbi bazën e saj të shesin energjinë e tyre elektrike me kushte të rregulluara.

2. Certifikata e origjinës do të jetë me madhësi standarde prej një (1) MWh. Jo më shumë se një certifikatë e origjinës do të lëshohet për secilën njësi të energjisë së prodhuar. Në certifikatën e origjinës Rregullatori do të specifikojë, së paku:

2.1. burimin e energjisë nga i cili është prodhuar energjia dhe datat e fillimit dhe përfundimit të prodhimit;

2.2. nëse prodhimi ka të bëjë me:

2.2.1. energji elektrike; apo

2.2.2. ngrohje dhe ftohje.

2.3. identitetin, lokacionin, llojin dhe kapacitetin e instalimeve ku është prodhuar energjia;

2.4. nëse dhe deri në çfarë mase instalimet në fjalë kanë përfituar nga përkrahja investuese, nëse dhe deri në çfarë mase njësia e energjisë ka përfituar në çfarëdo mënyre nga ndonjë skemë përkrahëse kombëtare, dhe llojin e skemës përkrahëse në fjalë;

2.5. datën në të cilën instalimet kanë hyrë në funksion; dhe

2.6. datën dhe vendin e lëshimit të numrit unik identifikues.

3. Rregullatori mbikëqyrë lëshimin, transferimin dhe anulimin e certifikatës së origjinës dhe duhet të krijojë mekanizma përkatës për të siguruar lëshimin, transferimin dhe anulimin elektronik të garancive të origjinës si dhe për të siguruar se ato janë të sakta, të besueshme dhe të pafalsifikueshme. Rregullatori do të sigurohet që çdo njësi e energjisë nga burimet e ripërtërishme të merret parasysh vetëm një herë.

4. Rregullatori duhet të njohë certifikatat e origjinës që lëshohen nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ekskluzivisht për të dëshmuar elementet të cilave iu referohet në paragrafin 2. nën-paragrafet 2.1. deri 2.6. të këtij neni, Rregullatori mund të refuzojë njohjen e certifikatës së origjinës vetëm në rastet kur ka dyshime të bazuara lidhur me saktësinë, besueshmërinë apo origjinalitetin e tyre. Rregullatori duhet ta njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për refuzimin në fjalë, duke ofruar edhe arsyetimin e vet.

5. Operatori i Sistemit të transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet që, në pajtim me kërkesat për besueshmëri dhe siguri operative, të sigurojnë dhe kontrollojnë tërë prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e kualifikuar të energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloret përkatëse, posaçërisht Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes.

6. Blerja e energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë, për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës nga Rregullatori, ka përparësi dhe duhet kryer sipas kushteve të parapara në Kodin e rrjetit të transmetimit për burime të energjisë së ripërtrishme dhe Rregullat e Tregut.

7. Kompensimi, pagesa e energjisë së prodhuar nga burimet e energjisë së ripërtërishme bëhet sipas tarifave për kompensimin e prodhimit të energjisë elektrike nga këto burime të cilat i mbledh Opertatori i Tregut nga furnizuesit e konsumatorëve fundorë, me përjashtim të sasisë për të cilën prodhuesit kanë lidhur kontratë për shitje, sipas dispozitave të këtij ligji.

8. Rregullatori duhet të realizojë aranzhime për të kompensuar shpenzimet shtesë, me të cilat përballen furnizuesit, për shkak të blerjes së energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen, përmes një takse specifike në shërbimet e operatorëve të sistemit, e cila u ngarkohet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të gjithë furnizuesve të lidhur në sistemin përkatës, në proporcion me energjinë e blerë të tyre nga burimet e energjisë së ripërtërishme.

9. Rregullatori, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, harton metodologjinë për përcaktimin e tarifave që duhet të paguajnë furnizuesit, për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e energjisë së ripërtërishme. Kjo metodologji duhet të përfshijë dispozita për kompensimin e furnizuesve, për koston shtesë për blerjen e energjisë elektrike, të prodhuar nga këto burime të energjisë.

10. Prodhuesit sipas paragrafit 1. të këtij neni kanë obligime të njëjta me prodhuesit tjerë në lidhje me shfrytëzimin e rrjetit, planifikimin dhe nominimin e prodhimit.

**Neni 9**

**Rezervat e lëndëve djegëse dhe/ose e kapacitetit prodhues**

1. Prodhuesit e licencuar të energjisë elektrike duhet të mbajnë sasi të mjaftueshme të rezervave të lëndëve djegëse, për të siguruar prodhim të vazhdueshëm dhe të besueshëm të energjisë elektrike, si dhe rezerva të veçanta për kapacitetet gjeneruese për të ofruar shërbime ndihmëse për operatorët e sistemit për një periudhë fillestare prej dy (2) vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kompensimi për këtë detyrim duhet të shqyrtohet nga Zyra e ndihmës shtetërore. Kostot e rezervës së lëndës djegëse dhe të kapacitetit rezervë të një prodhuesi konsiderohen si kosto operimi.

2. Niveli i rezervave të lëndëve djegëse që duhet të mbajnë prodhuesit e energjisë elektrike përcaktohet dhe publikohet rregullisht nga Ministria.

3. Ministria nxjerr akt nënligjor lidhur me nivelin e rezervave të lëndëve djegëse që duhet të mbajnë prodhuesit e energjisë elektrike.

## KAPITULLI III
## TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

### Neni 10
### Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit mban në pronësi sistemin e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin e këtij sistemi në Kosovë në pajtim me licencën e lëshuar nga Rregullatori.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit vepron në kuadër të ndërmarrjes së energjisë, e organizuar si shoqëri aksionare e pavarur.

### Neni 11
### Shthurja

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit mban në pronësi sistemin e transmetimit i cili duhet të jetë i pavarur nga veprimtaria e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike dhe të kryhet në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

2. Pavarësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit konsiderohet e siguruar, sipas këtij ligji, atëherë kur:

2.1. personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi ndërmarrjen, që kryen funksionet e prodhimit apo të furnizimit, nuk ushtrojnë kontroll apo të drejta mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo Sistemin e Transmetimit;

2.2. personi apo personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi Sistemin e Transmetimit nuk ushtrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çfarëdo kontrolli apo të drejte mbi ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit;

2.3. personi ose personat që emërojnë anëtarët e Bordit mbikëqyrës, bordit administrativ ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit nuk u lejohet që drejtpërdrejtë apo tërthorazi të ushtrojnë kontroll ose ndonjë të drejtë mbi ndërmarrjen që kryen aktivitete të gjenerimit ose furnizimit;

2.4. i njëjti person nuk ka të drejtë të jetë anëtar i Bordit mbikëqyrës, apo Bordit administrativ ose organeve tjera që ligjërisht i përfaqësojnë ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit dhe të atyre të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose Sistemit të Transmetimit;

2.5. të drejtat të cilave u referohet në nën-paragrafet 2.1., 2.2. dhe 2.3. të këtij neni përfshijnë, në mënyrë të posaçme:

2.5.1. autoritetin për të ushtruar të drejta të votimit;

2.5.2. autoritetin për të emëruar anëtarë të Bordit mbikëqyrës, Bordit administrativ apo organeve që ligjërisht e përfaqësojnë ndërmarrjen; apo

2.5.3. mbajtjen e shumicës së aksioneve.

3. Ndërmarrjet e energjisë që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit nuk kanë të drejtë që në mënyrë drejtpërdrejtë apo tërthortë të ushtrojnë çfarëdo lloj kontrolli apo të drejte mbi Operatorin e Sistemit Transmetimit si dhe anasjelltas.

4. Në rastet kur personi të cilit i referohet në nën-paragrafet 2.1.,2.2. dhe 2.3. të këtij neni, është organ publik, i njëjti nuk mund të ushtrojë kontroll mbi ndërmarrjet që janë aktive në prodhimin dhe /ose furnizimin e energjisë elektrike.

5. Para se një ndërmarrje të përcaktohet si Operator i Sistemit të Transmetimit sipas dispozitave të këtij neni, ajo duhet të certifikohet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

**Neni 12**

**Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit**

1. Me qëllim të zbatimit të nenit 11 të këtij ligji Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet.

2. Certifikimi bëhet nga Rregullatori sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës së procedurave të certifikimit të miratuara nga ajo.

**Neni 13**

**Qeverisja korporative, kompetencat, raportimi**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike, dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3. Aksionarin në mbledhjen vjetore të Bordit e përfaqëson i autorizuari i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

5. Bordi i Drejtorëve për veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza të rregullta vjetore dhe sa herë një gjë e tillë kërkohet nga Kuvendi. Raporti vjetor dorëzohet më së largu deri me 30 Qershor të vitit aktual për vitin paraprak.

6. Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të

Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kur, pas 2 (dy) vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performancës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Komisioni Funksional gjen se:

6.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë; dhe

6.2. dështimi i tillë i zbatimit ka dëmtuar seriozisht funksionimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sistemit të operimit të Transmetimit.

7. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të politikave të sektorit të energjisë, Qeveria duhet të mbahet e informuar nga Bordi i drejtorëve.

**Neni 14**
**Bordi i Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit**

1. Bordi i Drejtorëve i Operatorit të Sistemit të Transmetimit përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, njëri prej të cilëve është Kryesues i Bordit.

2. Kryesuesi dhe pesë (5) anëtarët tjerë të Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3. Kryeshefi Ekzekutiv, si anëtar i Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, emërohet nga Bordi i Drejtorëve sipas kritereve dhe procedurave të konkurrimit të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

4. Procedura për emërimin e Bordit të Drejtorëve, fillon me shpalljen e konkursit për propozimin e kandidatëve. Në konkurs theksohen kriteret për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Anëtarëve të Bordit, afati për konkurrim dhe dokumentet e nevojshme për konkurrim.

5. Procedurën e pranimit të aplikacioneve për postin e Kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit e zhvillon Ministria e Administratës Publike.

6. Kandidatët për anëtarë të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit zgjedhën sipas procedurave si në vijim:

6.1. brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit të drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, Ministria e Administratës Publike bën shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj;

6.2. Komisioni parlamentar përkatës për Energji pas pranimit të dosjes së aplikantve, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku dy (2) kandidatë për një pozitë të lirë.

7. Bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të pranishëm dhe që votojnë, zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar për secilën pozitë përkatëse të Bordit.

8. Mandati i secilit anëtar të Bordit është katër (4) vjeçar, me mundësi emërimi edhe për një mandat tjetër në vazhdim. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga data e emërimit nga Kuvendi i Republikës se Kosovës.

9. Nëse vendi i anëtarit të Bordit mbetet i lirë, anëtari i ri i Bordit emërohet me mandat deri në përfundim të mandatit të anëtarit të mëparshëm. Anëtari i ri mund të riemërohet për një mandat shtesë katër (4) vjeçar pas përfundimit të pjesës së mbetur të mandatit të anëtarit të mëparshëm.

10. Kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale të drejtorëve të Bordit janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

11. Kuvendi i Republikës së Kosovës mund të shkarkojë një drejtor të Bordit para përfundimit të mandatit të tij/saj në rastet kur anëtari:

11.1. është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

11.2. nuk është në gjendje shëndetësore të kryejë detyrat e tij/saj për më shumë se tre (3) muaj me radhë; dhe

11.3. nuk merr pjesë në më shumë se pesë (5) mbledhje të njëpasnjëshme, për çfarëdo arsye.

12. Kriteret dhe procedurat për shkarkimin e Anëtarëve dhe Kryesuesit të Bordit janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

13. Anëtarët e Bordit të Operatorit të Sistemit te Transmetimit, të cilët janë riemëruar në pozitën e tyre sipas këtij ligji do të shërbejnë në pozitën e anëtarit të Bordit deri në përfundimin e mandatit të tyre aktual, mirëpo, nuk mund të riemërohen përsëri.

14. Anëtarët të cilët janë emëruar në Bord sipas këtij ligji dhe të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë duke shërbyer mandatin e tyre të parë, do të shërbejnë në pozitën e anëtarit të Bordit deri në përfundimin e atij mandati dhe mund të riemërohen një herë.

15. Dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, lidhur me kompetencën për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarit, kompensimin e Bordit të drejtorëve dhe raportimin, dhe emërimin e Komisionit të Auditimit, nuk vlejnë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

16. Paga e Kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit dhe Komisionit të Auditimit, përcaktohen nga Kuvendi deri në nxjerrjen e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publik.

**Neni 15**
**Komisioni i Auditimit**

1. Pas zgjedhjes së Drejtorëve të Bordit, Kuvendi nga personat e përzgjedhur për të shërbyer si Drejtor emëron tre (3) anëtare të Komisionit të Auditimit, nga të cilët njëri është Kryesues i Komisionit të Auditimit.

2. Kualifikimet dhe përvoja profesionale për Anëtarët e Komisionit të Auditimit janë të përcaktuara në Ligjin për ndërmarrje publike.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Auditimit janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

**Neni 16**
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë:

1.1. transmetimi i energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në licencë, në mënyrë objektive, transparente dhe jo diskriminuese në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke ruajtur sigurinë e sistemit elektroenergjetik sipas këtij ligji;

1.2. operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri afatgjatë të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit;

1.3. operimi i sistemit të Transmetimit në pajtueshmëri me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera të zbatueshme, në mënyrë që të arrijë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimin ekonomik të rrjetit të Transmetimit;

1.4. planifikimi i operimit të sistemit elektroenergjetik, në bashkëpunim me Operatorin e Tregut dhe operatorët e sistemeve transmetuese fqinje si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe shfrytëzuesve të Rrjetit;

1.5. publikimi i rregullave të sigurisë, operimit dhe planifikimit të rrjetit, të miratuara nga Rregullatori. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të operojë në pajtim me rregullat e operimit dhe të mbajë një nivel të përcaktuar të sigurisë së rrjetit. Rregullat e publikuara duhet të përfshijnë skema të përgjithshme për kalkulimin e kapaciteteve totale transmetuese dhe margjinat e sigurisë së transmetimit;

1.6. mbajtja e një niveli të përshtatshëm të kapacitetit të rezervave teknike të transmetimit, për sigurinë operuese të rrjetit dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i sigurisë operuese të rrjetit me operatorët e sistemeve të Palëve Kontraktuale të Komunitetit të energjisë me të cilat është i lidhur;

1.7. këmbimi i informacioneve me operatorët relevantë të sistemeve të interkonektuara, lidhur me operimin e rrjetit, në kohë dhe në mënyrë efektive, në përputhje me kërkesat minimale të operimit;

1.8. përdorimi i pajisjeve të sistemit të transmetimit në përputhje me rregullat dhe standardet teknike;

1.9. koordinimi i planeve të remontit të stabilimenteve transmetuese dhe stabilimenteve të shfrytëzuesve të rrjetit;

1.10. financimi i bazuar në studimet e bëra, për ndërtimin e linjave të reja të transmetimit,

interkonektorëve dhe stabilimenteve tjera të domosdoshme për operim, mirëmbajtje, zhvillim dhe menaxhim të mirëfilltë të sistemit të transmetimit në Kosovë;

1.11. përgatitja e planeve dhjetë (10) vjeçare në përputhje me Ligjin për Energji dhe përmbushja e detyrimeve në lidhje me këto plane;

1.12. përpilimi brenda vitit që i paraprinë periudhës pesë (5) vjeçare, planin pesë (5) vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Ky plan duhet të miratohet nga Rregullatori para se të publikohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe duhet të jetë i harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, dokumentacionin e planifikimit hapësinor dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

1.13. zhvillimi dhe publikimi, brenda vitit, që i paraprinë vitit të parë të Planit investiv, Planin investiv pesë (5) vjeçar, të miratuar paraprakisht nga Rregullatori të harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar dhe atë pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe dokumentacionit të planifikimit hapësinor;

1.14. marrja e masave për zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e mjedisit;

1.15. përgatitja e balancave vjetore dhe afatgjata të parashikimit dhe mbulimit të kërkesës për energji elektrike, në përputhje me Ligjin për Energji dhe metodologjinë për përgatitjen e këtyre balancave, që miratohet nga Rregullatori;

1.16. hartimi i metodologjive tarifore për qasje dhe kyçje në sistemin e transmetimit të Kosovës dhe aplikimin e tarifave jo diskriminuese që ofrojnë sinjale efikase ekonomike për shfrytëzuesit e sistemit, përfshirë këtu edhe menaxhimin e kongjestionit të cilat miratohen nga Rregullatori dhe publikohen në faqen elektronike të Operatorit të Sistemit të transmetimit, pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara datës së fillimit të aplikimit;

1.17. aplikimi i metodologjisë së njëjtë tarifore në tërë territorin e Kosovës, për kategori të njëjtë të shfrytëzuesve të rrjetit të transmetimit, veçanërisht në lidhje me nivelin e tensionit dhe madhësitë elektrike si fuqia, energji aktive, energjia reaktive dhe kritere tjera;

1.18. përpilimi i rregullave të çmimit për shërbimet jo standarde të Operatorit të Sistemit të transmetimit dhe t'i publikojë ato pas miratimit nga Rregullatori, pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara datës së fillimit të aplikimit. Në rast të refuzimit të miratimit, Rregullatori mund të përcaktojë vetë këto çmime;

1.19. balancimi i sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut;

1.20. menaxhimi i rrjedhave të energjisë, në sistemin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet me sistemet fqinje, me qëllim të mbajtjes së balancës mes furnizimit dhe kërkesës dhe sigurimit të efikasitetit ekonomik të menaxhimit të rrjedhave të energjisë duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit;

1.21. rregullimi frekuencë - fuqi;

1.22. prokurimi i shërbimeve balancuese për balancim të sistemit, në bazë të parimeve të tregut dhe parimeve të transparencës dhe jodiskriminimit;

1.23. shfrytëzimi i energjisë balancuese në përputhje me Rregullat e Tregut dhe sipas listës së ofertave të parimit ekonomik;

1.24. sigurimi i disponueshëmrisë së të gjitha shërbimeve ndihmëse, përfshirë edhe procesin e menaxhimit nga ana e kërkesës;

1.25. analizimi i humbjeve në rrjetin e transmetimit në baza vjetore dhe, nëse është e nevojshme, të zhvillojë dhe zbatojë masa për zvogëlimin e tyre;

1.26. mirëmbajtja e një regjistri të pikave matëse komerciale në kufirin me rrjetin e transmetimit për çdo palë përgjegjëse për balancë apo çdo grupi përgjegjës për jobalancë;

1.27. mirëmbajtja e sistemeve matëse, mbledhja dhe procesimi i të dhënat nga pikat matëse komerciale të përdoruesve të rrjetit, në përputhje me këtë ligj, rregulloret dhe Kodin e Matjes;

1.28. matja e energjisë elektrike të pranuar dhe atë të dorëzuar në pikat që ndajnë rrjetin e transmetimit me rrjetin shpërndarjes, me përdoruesit e sistemit të transmetimit, me sistemet fqinje dhe pika të tjera të rëndësishme dhe shkëmbimi i tyre në mënyrë reciproke me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, operatorët e sistemeve fqinje dhe shfrytëzuesit e sistemeve dhe vënia në dispozicion të Rregullatorit;

1.29. dërgimi i të dhënave matëse nga pikat komerciale dhe nga pikat e ndarjes me sistemet fqinje, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të rregullave të matjes ose sipas marrëveshjes bilaterale në mes të Operatorit të Sistemit të transmetimit dhe palëve të kyçura në rrjetin e transmetimit;

1.30. përcaktimi i kërkesave teknike dhe i kostove të instalimit të pajisjeve matëse të avancuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera që rregullojnë sektorin e energjisë;

1.31. kyçja e shfrytëzuesve në rrjetin e transmetimit dhe krijimi i kushteve teknike për kyçje, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionit në fuqi që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike;

1.32. dhënia shfrytëzuesve të rrjetit, informacionet që ju nevojiten për qasje dhe shfrytëzim efikas të rrjetit të transmetimit;

1.33. formimi i një komisioni për ankesa, në lidhje me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe krijimi i një mekanizimi të pavarur për zgjidhjen jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve;

1.34. publikimi i informacioneve që janë të rëndësishme për shfrytëzuesit e rrjetit të transmetimit duke përfshirë: kapacitetet ndërkufitare, ngulfatjet në interkonektor dhe në brendësi të rrjetit të transmetimit, si dhe informacione të tjera të nevojshme për organizimin e tregut të energjisë elektrike;

1.35. sigurimi i besueshmërisë dhe disponueshëmrisë së sistemit të transmetimit, në mënyrë që të mundësojë furnizim të sigurt me energji elektrike, duke mbajtur

mjaftueshmërinë e kapaciteteve transmetuese;

1.36. sigurimi që ndërprerjet në furnizim në situata emergjente, siç parashihet në Ligjin për Energji, të bazohen në kritere të parapërcaktuara dhe objektive të cilat përgatiten nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe miratohen nga Rregullatori;

1.37. veprimi në përputhje me rregullat dhe standardet e cilësisë së furnizimit dhe sigurisë së sistemit që përcaktohen nga Rregullatori;

1.38. sigurimi përdoruesve qasje dhe shfrytëzim të rrjetit të transmetimit sipas parimeve transparente dhe jo diskriminuese;

1.39. dhënia e udhëzimeve të nevojshme sistemit të transmetimit dhe njësive prodhuese për funksionimin e sigurt të sistemit, në përputhje me kriteret e besueshmërisë dhe të sigurisë të sistemit të transmetimit të parapara në Kodin e rrjetit të transmetimit;

1.40. ofrimi i informatave operatorëve të sistemeve fqinje, me të cilët është i ndërlidhur sistemi i transmetimit, me qëllim të arritjes së operimit të sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve të interkonektuara;

1.41. alokimi i kapaciteteve ndërkufitare transmetuese, në bashkëpunim me operatorët e sistemeve të transmetimeve të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, sipas procedurave të përbashkëta rajonale për kalkulimin dhe alokimin e kapaciteteve, të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe të miratuara nga Rregullatori; Këtë të drejtë mund ta transferojë tek ndonjë subjekt tjetër rajonal i themeluar për këtë qëllim;

1.42. menaxhimi i kongjestionit, për të gjitha transaksionet në interkonektorët me sistemet fqinje, në bazë të rregullave dhe mekanizmave të tregut, të cilët përcaktohen dhe zbatohen së bashku me operatorët e tjerë në tregun rajonalë të energjisë elektrike;

1.43. dispeçimi i prodhimit dhe shfrytëzimi i interkonektorëve të bëhet në bazë të kritereve të miratuara nga Rregullatori që duhet të jenë objektive, të publikohen dhe të aplikohen në mënyrë jo diskriminuese në mënyrë që të mundësojnë funksionim të përshtatshëm të tregut të energjisë elektrike. Kriteret duhet të marrin parasysh përparësitë ekonomike të njësive prodhuese në dispozicion, transferet ndërkufitare si dhe kufizimet teknike në sistem;

1.44. dhënia e prioritetit dispeçimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimit, me kusht që të mos bie ndesh me kufizimet e përcaktuara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe rregullat e rregulloret tjera për sigurinë e sistemit;

1.45. kryerja e të gjitha veprimtarive tjera të parapara me këtë Ligj dhe me ligjet tjera të zbatueshme.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit bën aktivizimin e ofertave të energjisë balancuese me palët që kanë ofruar shërbime ndihmëse dhe palët përgjegjëse për jobalanc që kanë shkaktuar jobalanc.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme

njerëzore, teknike, fizike dhe financiare, për operimin e sigurt, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të transmetimit.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit i raporton Rregullatorit, siç përcaktohet në licencën e tij sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe i ofron asaj informata mbi të gjitha çështjet që mund të kërkohen, në formën dhe në intervalet e parapara nga Rregullatori.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit ofron informata të nevojshme njësive të qeverisjes lokale për qëllime të planifikimit të tyre të zhvillimit, duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave të përdoruesve individualë të rrjetit.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për zbatimin e Kodit të rrjetit të transmetimit dhe raporton në baza vjetore te Rregullatori.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për lejimin dhe menaxhimin e qasjes/kyçjes së palës së tretë, duke përfshirë inkasimin e pagesave që i detyrohen palët për kyçje dhe qasje në rrjetin e transmetimit, në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për mbledhjen e të hyrave nga alokimi i kapaciteteve interkonektive dhe pagesave në kuadër mekanizmit të kompensimit ndërmjet OST-ve.

9. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për pagesat sipas kontratave të lidhura, për shërbimet tjera të siguruara, përfshirë edhe shpenzimet e ndërlidhura me pjesëmarrjen e tij në organizata ndërkombëtare, pjesëmarrje kjo që buron nga detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian.

**Neni 17**

**Kodi i rrjetit të transmetimit**

1. Operimi dhe menaxhimi i rrjetit të transmetimit do të udhëhiqet nga Kodi i rrjetit të transmetimit.

2. Kodi i rrjetit të transmetimit përcakton:

2.1. kushtet teknike dhe kërkesa të tjera të cilave duhet t’iu përmbahen përdoruesit e lidhur në rrjetin e transmetimit;

2.2. kushtet teknike dhe kërkesa tjera për transmetim të sigurt të energjisë elektrike nga prodhues dhe sistemet tjera dhe operim të sigurt të sistemit të transmetimit për furnizim të besueshëm dhe cilësor të energjisë elektrike të konsumatorët fundorë;

2.3. kushtet teknike për qasje në rrjet të transmetimit;

2.4. kushtet teknike për mirëmbajtje të rrjetit të transmetimit;

2.5. përgjegjësitë teknike të përdoruesve të rrjetit të transmetimit;

2.6. planifikimin operativ dhe menaxhimin e sistemit të transmetimit;

2.7. procedurat për operimin e sistemit të energjisë elektrike në kushte të operimit normal dhe fuqisë madhore, rrjeteve të çrregulluara, rrjeteve të jashtëzakonshme apo rrethanave tjera të jashtëzakonshme;

2.8. zonat e mbrojtura dhe kushtet e veçanta brenda fushës së mbrojtur të stabilimenteve elektrike;

2.9. llojet dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse të sistemit;

2.10. kushtet teknike dhe kushtet tjera për interkoneksion dhe operim të rrjeteve;

2.11. planifikimin zhvillimor të rrjetit të transmetimit;

2.12. dizajnin teknik dhe kërkesat operative për kyçje në sistem që do të sigurojë bashkëveprimin e sistemeve dhe do të jenë objektive dhe jodiskriminuese.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit zhvillon Kodin e rrjetit të transmetimit ndërsa Rregullatori miraton atë. Gjatë zhvillimit të Kodit të rrjetit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit obligohet që të sigurojë pjesëmarrje adekuate të të gjitha palëve me interes dhe të organizojë dëgjime publike për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë. Kodi i rrjetit të transmetimit duhet të publikohet në faqen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

**Neni 18**

**Kodi i Matjes**

1. Instalimi, operimi dhe menaxhimi i sistemit të matjes në kufij të rrjetit të transmetimit kryhet në bazë të Kodit të Matjes.

2. Kodi i Matjes përcakton:

2.1. karakteristikat e pajisjeve matëse në pikat matëse të përdoruesve të rrjetit;

2.2. tiparet e pajisjeve matëse apo standardeve që duhet të plotësohen nga pajisjet matëse për të mundësuar menaxhimin e kërkesës dhe matjen e konsumit të energjisë elektrike në intervale kohore;

2.3. tiparet e pajisjeve matëse apo standardeve që duhet të plotësohen nga pajisjet në pikat e matjes që përdoruesi duhet t'i përmbushë, kushtet funksionale, saktësinë e pajisjeve matëse dhe metodat për matjen e energjisë elektrike në sistemin e transmetimit, në veçanti në kuptim të:

2.3.1. metodës së instalimit, pranimit, testimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve matëse;

2.3.2. metodës së grumbullimit, të leximit të njehsorëve dhe të dhënave tjera në pikat matëse; dhe

2.3.3. qasshmërisë, përpunimit të të dhënave dhe bartjes së leximeve nga njehsorët dhe të dhënave tjera tek përdoruesit e të dhënave, si dhe grumbullimi

dhe arkivimi i të dhënave.

2.4. përcaktimit të standardeve teknike dhe zgjidhjeve për instalimin e sistemeve matëse për përdoruesit e rrjetit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit zhvillon ndërsa Rregullatori miraton Kodin e Matjes. Gjatë zhvillimit të Kodit të Matjes, Operatori i Sistemit të transmetimit obligohet që të sigurojë pjesëmarrje adekuate të të gjithë akterëve dhe të organizojë dëgjime publike për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë. Kodi i Matjes publikohet në ueb-faqen e Operatorit të Sistemit të transmetimit.

**Neni 19**

**Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të angazhohet në prokurimin e energjisë dhe kapacitetit, bazuar në procedura transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg vetëm për qëllimet në vijim:

1.1. humbjet në rrjetin e transmetimit;

1.2. balancimin e sistemit;

1.3. ofrimi i shërbimeve ndihmëse sipas procedurës transparente, jodiskriminuese dhe të bazuar në treg.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit, energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit duhet ta blejë në tregun e energjisë elektrike. Nëse ofron dëshmi për çdo rast individual tek Rregullatori se një blerje e tillë fizikisht nuk është e mundur, Rregullatori mund të kërkojë nga prodhuesit që të ofrojnë energjinë elektrike të kërkuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit. Rregullatori në bazë të raporteve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, prodhuesit dhe subjektet e tjera, të zbatojnë obligimet e shërbimit publik për të siguruar mbulimin e humbjeve në transmetim.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron shërbimet e sistemit në përputhje me parimet e tregut dhe të kontratave për ofrimin e shërbimeve. Shfrytëzimi i shërbimeve të ofruara nga ofruesi i shërbimeve ndihmëse dhe shërbimeve balancuese mund të bëhet me kërkesë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

4. Rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë të gjitha rregullat për koston e jobalancimit nga shfrytëzuesit e sistemit. Rregullat për balancimin duhet të dorëzohen për miratim nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në Rregullator. Termat dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të tilla nga Operatori i Sistemit të Transmetimit do të përcaktohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga Rregullatori dhe duhet të jenë jodiskriminuese dhe me kosto reflektuese dhe duhet të publikohen.

**Neni 20**
**Informatat konfidenciale**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ruajë informatat konfidenciale gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta. Publikimi apo zbulimi i informacioneve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit lidhur me veprimtarinë e tij që mund t'i sjell përparësi ose përfitim ndonjë personi tjetër, kryhet në mënyrë jodiskriminuese.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Ministria përgjegjëse për energji apo Rregullatori mund të kërkojnë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit informacione konfidenciale të domosdoshme për t'i zbatuar funksionet, autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

**Neni 21**
**Promovimi i bashkëpunimit rajonal**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit përfaqëson Kosovën në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit, me pëlqimin paraprak të Rregullatorit, merr pjesë në operimin e një ose më shumë sistemeve të integruara në kuadër të një ose më shumë rajoneve të cilat mbulohen nga një ose më shumë palë të Komunitetit të Energjisë me qëllim të llogaritjes së koordinuar të kapaciteteve ndërkufitare dhe alokimit të koordinuar të kapaciteteve ndërkufitare dhe verifikimit të sigurisë operative dhe me qëllim të themelimit dhe zhvillimit të tregjeve rajonale të energjisë elektrike dhe liberalizimin e tyre.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të promovojë marrëveshjet operative në mënyrë që të sigurohet menaxhim optimal të rrjetit të Komunitetit të Energjisë dhe do të nxisë zhvillimin e shkëmbimeve të energjisë, alokimin e koordinuar të kapacitetit ndërkufitar përmes gjetjes së alternativave jodiskriminuese të bazuara në treg, duke i kushtuar vëmendje meritore të veçantë ankandeve implicite për alokimet afatshkurtra, dhe integrimin e mekanizmave të balancimit dhe kapacitetit rezervë.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit merr parasysh opinionet, rekomandimet dhe zbaton vendimet e institucioneve të krijuara në Komunitetin e Energjisë, apo në Bashkimin Evropian, në rastet kur këto organizata janë të mandatuara, nga marrëveshjet apo rregulloret ndërkombëtare të obligueshme për Kosovën.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit bashkëpunon me organizata nga paragrafi 4. i këtij neni për sigurimin e informatave të domosdoshme lidhur me planet zhvillimore të rrjetit, përdorimit dhe zhvillimit të interkonektorëve dhe bashkëpunimit rajonal.

**KAPITULLI IV**
**ORGANIZIMI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Neni 22**
**Tregu i energjisë elektrike**

1. Tregu i energjisë elektrike përfshinë tregjet e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë.

2. Shitblerja në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë kontraktohet nëpërmjet kontratave bilaterale dhe nëpërmjet tregut të organizuar të energjisë elektrike.

3. Tregu bilateral i energjisë elektrike është tregu ku blerja dhe shitja e energjisë elektrike realizohet drejtpërdrejtë ndërmjet pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike në bazë të marrëveshjes bilaterale për shitblerjen e energjisë elektrike.

4. Tregtimi i energjisë elektrike në kuadër të tregut të energjisë bëhet lirshëm dhe në bazë të interesave ekonomike të secilit pjesëmarrës.

5. Ndërmarrjet e energjisë të cilat janë në pronësi publike dhe ato ndërmarrje që ofrojnë shërbime publike, tregtimin (shitblerjen) e energjisë elektrike, të nevojshme për realizimin e obligimeve dhe të drejtave sipas licencës, e bëjnë në pajtim me Procedurat për tregtimin e energjisë elektrike, të cilat propozohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, të cilat miratohen dhe publikohen nga Rregullatori. Për të siguruar efikasitetin e kostos dhe çmimin më të lirë të mundshëm, duke pasur parasysh specifikat e tregut të energjisë elektrike, këto procedura nuk i nënshtrohen kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për miratimin një ditë para të programeve të shitblerjeve të energjisë elektrike të palëve brenda Republikës së Kosovës dhe programeve ndërkufitare, në bazë të obligimeve kontraktuale që rrjedhin nga shitblerja në tregun e energjisë elektrike.

7. Operatori i Tregut dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit janë përgjegjës për organizimin e tregut një ditë para dhe atij ndërditor për tregtimin fizik të energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe për bashkimin e tij me tregjet tjera të energjisë elektrike. Mundësia e konstituimit të ankandeve të energjisë elektrike nuk do të kufizohet nga Operatori i Tregut.

8. Operatori i Sistemi të Transmetimit është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e tregut të balancimit të energjisë elektrike.

9. Në tregun balancues të energjisë elektrike, Operatori i Sistemi të Transmetimit pranon ofertat për shitje dhe ofertat për blerje në tregun balancues për nevoja të balancimit të sistemit elektroenergjetik, dhe për të garantuar sigurinë e punës së sistemit elektroenergjetik, ndërmerr masa dhe i aktivizon ofertat për shitje dhe ofertat për blerje të energjisë elektrike për balancim, në bazë të një liste të ofertave sipas përparësisë ekonomike.

10. Operatori i Sistemit të Tregut është përgjegjës për llogaritjen e jobalancit të energjisë elektrike dhe çmimit të jobalancit, për çdo pjesëmarrës, për çdo periodë të barazimit përfundimtar dhe faturimin në përputhje me Rregullat e Tregut.

11. Pjesëmarrja në tregun balancues të energjisë elektrike rregullohet me marrëveshje për ofrimin e shërbimit balancues të cilën Operatori i Sistemit të Transmetimit e përmbyllë me pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike. Marrëveshja e tillë përmban një pjesë të rregullave të tregut në lidhje me balancimin e energjisë elektrike dhe barazimin përfundimtar të energjisë balancuese.

12. Operatori i Tregut bënë barazimin përfundimtar financiar për shërbimet e ofruara të balancimit.

13. Operatori i Sistemit të Transmetimit njofton Rregullatorin për kontratat e përmbyllura për

shërbimet balancuese me ofruesit e shërbimit të balancimit dhe për zbatimin mujor të kontratave të tilla pas kërkesës së Rregullatorit.

**Neni 23**
**Operatori i Tregut**

1. Operatori i Tregut përzgjidhet nga Qeveria përmes një procesi të hapur.

2. Operatori i Tregut duhet të jetë i pavarur, në formën e saj juridike, marrëdhënieve pronësore, strukturave organizative dhe vendimmarrëse, nga të gjitha aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me transmisionin e energjisë elektrike.

3. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Tregut personat përgjegjës për menaxhimin e tij nuk mund të marrin pjesë në struktura apo procese vendimmarrëse të Ministrisë, Rregullatorit si dhe ndërmarrjeve përgjegjëse për prodhim, furnizim, shpërndarje të energjisë elektrike apo të mihjeve të thëngjillit dhe furnizimeve tjera me lëndë djegëse.

4. Për kryerjen e veprimtarisë të organizimit të tregut, Operatori i Tregut pajiset me licencë nga Rregullatori.

5. Operatori i Tregut është përgjegjës për organizimin e tregut të energjisë elektrike në tërë territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me Rregullat e Tregut të miratuara nga Rregullatori.

6. Operatori i Tregut përgatitë propozimin për Modelin e tregut të energjisë elektrike dhe modifikimin e tij në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Modeli i tregut të energjisë elektrike miratohet nga Rregullatori.

7. Mbi bazën e Modelit të tregut të energjisë elektrike, Operatori i Tregut përgatitë Rregullat e Tregut me shumicë të energjisë elektrike të cilat i rishikon rregullisht në lidhje me ndryshimet që konsiderohen të arsyeshme dhe të nevojshme. Këto rregulla duke përfshirë edhe propozimet për ndryshim, të cilat dërgohen për miratim te Rregullatori. Pas miratimit Rregullat e Tregut të energjisë elektrike janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

8. Tarifat për detyrimet që paguhen për operimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike përcaktohen nga Rregullatori sipas Metodologjisë tarifore për operim të tregut të energjisë elektrike të propozuar nga Operatori i Tregut dhe që miratohen nga Rregullatori. Propozimi i Operatorit të Tregut bazohet në shpenzimet e arsyeshme të biznesit dhe duhet të jetë i harmonizuar me Programin vjetor të biznesit dhe Planin financiar të tij.

9. Operatori i Tregut është përgjegjës për:

9.1. menaxhimin ekonomik të sistemit elektroenergjetik. Ai menaxhon dhe operon me tregun e energjisë elektrike sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjeve tjera të aplikueshme;

9.2. organizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në dobi dhe në të mirë të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike;

9.3. organizimin dhe zhvillimin e tregut të organizuar së energjisë elektrike në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit;

9.4. regjistrimin e të gjitha transaksioneve shitblerëse të energjisë elektrike ndërmjet palëve në tregun e energjisë elektrike;

9.5. dorëzimin me kohë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të programeve ditore të shitblerjes së energjisë elektrike;

9.6. verifikimin e harmonizimit të programeve kontraktuale të shitblerjeve ndërkufitare me kapacitetet e alokuara ndërkufitare;

9.7. mbajtjen e evidencës së pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike;

9.8. përmbylljen e marrëveshjes për shitblerjen e pjesës së obligueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga energjia e burimeve të ripërtërishme dhe bashkëprodhimi;

9.9. grumbullimin e pagesave për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga energjia e burimeve të ripërtërishme dhe bashkëprodhimi, nga të gjithë furnizuesit, duke përfshirë edhe furnizuesit me obligim të shërbimit publik;

9.10. analizën e organizimit të tregut të energjisë elektrike dhe propozimin e masave për avancimin e tij;

9.11. publikimin, në mënyrë të përcaktuar, të informatave të nevojshme për organizimin e papenguar të tregut të energjisë elektrike dhe realizimin e veprimtarive të energjisë elektrike;

9.12. ofrimin e mendimeve Operatorit të Sistemit të Transmetimit për rregullat për alokimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare;

9.13. organizimin e ankandeve për shitblerjen e energjisë elektrike, varësisht nga modeli i tregut dhe mekanizmat tregtues, si dhe bën pranimin e ofertave për shitje dhe të ofertave për blerje të energjisë elektrike në kushtet e tregut të organizuar;

9.14. përcaktimin e çmimit të tregut në rastin e tregut të organizuar për çdo periudhë kohore të specifikuar dhe njoftimin e të gjitha palëve pjesëmarrëse mbi detyrimet e ndërsjella;

9.15. njoftimin e pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit mbi rezultatet e ankandeve të tregut të organizuar dhe informata tjera rreth tregut të energjisë elektrike;

9.16. menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtar financiar dhe faturimit në tregun e organizuar të energjisë elektrike, alokimin e kapaciteteve interkonektive, mekanizmit balancues, detyrimeve për qasje në rrjetin transmetues në bazë të dhënave të pranuara nga operatorët e sistemeve;

9.17. menaxhimin e procesit të transferimit të konsumatorëve në përputhje me Rregullat e Tregut;

9.18. instalimin, mirëmbajtjen dhe azhurnimin e platformës për operimin e tregut. Kjo platformë duhet të mundësojë auditim të pavarur;

9.19. publikimin e të dhënave dhe informatave relevante të tregut dhe obligimeve tjera që dalin nga Rregullat e Tregut.

10. Operatori i Tregut kryen detyrat e veta duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe pavarësisë, nën mbikëqyrjen e Rregullatorit.

11. Në pikëpamje të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, Operatori i Tregut realizon pjesën komerciale të biznesit, nëpërmes rregullave për llogaritjen e energjisë balancuese që përfshihen në rregullat e organizimit të tregut balancues të energjisë elektrike, që paraqesin pjesë përbërëse të organizimit të tregut të energjisë elektrike dhe shërbejnë për përpunimin e pjesës komerciale të balancimit të sistemit elektroenergjetik. Pjesa komerciale e biznesit përfshinë:

11.1. organizimin e shitblerjes së energjisë balancuese nga ofruesit e shërbimeve, që përfshinë grumbullimin e ofertave, përpilimin e listës së përparësisë ekonomike dhe përcjelljen e saj tek Operatori i Sistemit të Transmetimit si dhe pagesat për ofruesit e shërbimit; dhe

11.2. organizimin e shitblerjes të energjisë balancuese nga ana e ngarkesës, që përfshinë edhe llogaritjet dhe pagesat e energjisë balancuese për shkak të balancimit si pasojë e devijimeve që janë shkaktuar nga subjektet përgjegjëse për devijime, gjegjësisht palët apo grupet përgjegjëse për balancim.

12. Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike janë të obliguar që t’i sigurojnë Operatorit të Tregut qasje të pakufizuar dhe të vazhdueshme në të dhënat që i nevojiten për realizimin e veprimtarive në përputhje me Rregullat e Tregut.

**Neni 24**

**Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike**

1. Pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike mund të jetë një ndërmarrje e energjisë ose person juridik ose fizik që blenë ose shet energji elektrike brenda dhe jashtë Kosovës.

2. Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike janë:

2.1. prodhuesi;

2.2. tregtari i energjisë elektrike;

2.3. furnizuesi;

2.4. konsumatori me shumicë ose konsumatori fundor.

3. Detyrimet e ndërsjella të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike rregullohen me kontrata në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe të Rregullave të Tregut.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes janë pjesëmarrës në treg vetëm për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues dhe rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit. Me qëllim të arritjes së konkurrencës në tregun e energjisë dhe me synim të plotësimit të kërkesës për energji elektrike në Kosovë, në kuadër të dispozitave të këtij Ligji dhe ligjeve tjera në fuqi, pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike mund të lidhin kontrata për shitjen apo blerjen e energjisë elektrike me:

4.1. ndërmarrje tjera të energjisë dhe me konsumatorë brenda Kosovës;

4.2. ndërmarrje tjera të energjisë elektrike dhe konsumatorët në sistemet tjera të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë sa kohë që furnizuesit i zbatojnë rregullat e aplikueshme të tregtimit të energjisë së balancimit.

**Neni 25**

**Përgjegjësitë për balancim të pjesëmarrësve në treg**

1. Secili pjesëmarrës në treg të energjisë elektrike ka përgjegjësi për balancim.

2. Pjesëmarrësi i tregut i energjisë elektrike mund të lidhë marrëveshje, lidhur me përgjegjësitë e tij të balancimit, duke lidhur kontratë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe kështu fiton statusin e palës me përgjegjësi të balancimit.

3. Pjesëmarrësi i tregut të energjisë elektrike mund të lidhë marrëveshje, lidhur me përgjegjësitë e balancimit, për transferimin e përgjegjësisë se balancimit, tek një përfaqësues i zgjedhur prej tij e që është palë me përgjegjësi të balancimit, duke u bërë kështu anëtar i grupit të palës me përgjegjësi të balancimit.

4. Rregullat e Tregut duhet të specifikojnë kërkesat dhe procedurat për përgjegjësitë e balancimit të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike, kontratat e përgjegjësive të balancimit dhe përgjegjësinë për ruajtjen e regjistrit të palëve përgjegjëse për balancim.

**Neni 26**

**Zhvillimi i Konkurrencës**

1. Rregullatori, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndihmës Shtetërore, së paku çdo dy (2) vite duhet të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike. Raportet e Rregullatorit duhet të publikohen pa vonesë.

2. Rregullatori mund të përcaktojë masa të nevojshme dhe proporcionale të obligimeve të shërbimit publik, me qëllim të nxitjes të konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut të energjisë elektrike. Këto masa mund të përfshijnë programet për ofrimin në treg të sasive të caktuara të energjisë elektrike, sipas të cilit subjektet obligohen të shesin ose të vënë në disponim sasi të caktuara të energjisë elektrike ose mundësimin e qasjes në një pjesë të kapaciteteve të tyre prodhuese, furnizuesve të interesuar, për një periudhë kohore të caktuar.

3. Masat e parapara me paragrafin 2. të këtij neni do të përcaktohen me një akt të veçantë i cili hartohet dhe miratohet nga Rregullatori pas konsultimit me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë.

## KAPITULLI V
## SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

### Neni 27
### Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përzgjidhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të një procedure konkurruese. Pas përzgjedhjes operatori i nënshtrohet procedurës së licencimit nga Rregullatori dhe mund të operojë vetëm pasi të pajiset me licencë.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes udhëheq me asetet e rrjetit të shpërndarjes dhe është i pavarur, në vendimmarrjet operative dhe planifikuese, nga aktivitetet e gjenerimit dhe furnizimit.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kryen veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas kushteve specifike të përcaktuara në licencë dhe parimeve objektive, transparente dhe jodiskriminuese në territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes operon, mirëmban, zhvillon dhe ndërton rrjetin e shpërndarjes, me qëllim që të sigurojë shpërndarje të energjisë elektrike në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe afatgjate.

5. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e ndonjë ndërmarrje e integruar vertikalisht të energjisë elektrike, ai duhet të jetë i pavarur nga të gjitha veprimtaritë tjera që nuk ndërlidhen me shpërndarjen, së paku sa i përket formës juridike, organizimit apo vendimmarrjes.

6. Për të siguruar pavarësinë sipas paragrafit 5. të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, zbaton kriteret minimale si në vijim:

6.1. personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk mund të jenë pjesëmarrës në strukturat e ndonjë ndërmarrje të integruar vertikalisht të energjisë elektrike përgjegjëse, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, për operimin ditor të prodhimit, transmetimit apo furnizimit me energji elektrike;

6.2. duhet të ndërmerren masa të përshtatshme për t’u siguruar se janë marrë në konsideratë interesat profesionale të personave përgjegjës, për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në mënyrë të përshtatshme që siguron se ata janë të aftë të veprojnë në mënyrë të pavarur;

6.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejta efektive vendimmarrëse, në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja e energjisë elektrike e integruar vertikalisht, sa i përket aseteve të domosdoshme për të operuar, mirëmbajtur dhe zhvilluar sistemin e shpërndarjes në mënyrë të besueshme, efikase dhe me siguri afatgjate;

6.4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për operimin e sigurtë, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të shpërndarjes;

6.5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton dhe ia paraqet për miratim Rregullatorit, Programin e pajtueshmërisë, në të cilin përcaktohen masat të cilat duhet të ndërmerren për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe që sigurojnë monitorimin adekuat të tij. Për

arritjen e objektivit të tij, në Program të Pajtueshmërisë duhet përcaktohen detyrimet specifike të punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Personi apo organi përgjegjës për monitorimin e Programit të pajtueshmërisë, Zyrtari i pajtueshmërisë dorëzon te Rregullatori, raportin vjetor i cili bëhet publik ku përfshihen masat të cilat janë ndërmarrë. Zyrtari i pajtueshmërisë me qëllim të kryerjes së detyrave të tij duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe duhet të ketë qasje në të gjitha informatat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të ndonjë ndërmarrje të ndërvarur të tij.

7. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të pengojnë prezencën e mekanizmave të përshtatshëm të koordinimit, për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale të ndërmarrjes amë sa i përket fitimit nga asetet, të rregulluara në mënyrë të tërthortë mbi ndërmarrjen vartëse Në veçanti, duhet t'i mundësohet ndërmarrjes amë që ta miratojë planin vjetor financiar, apo ndonjë instrument ekuivalent, të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të përcaktojë kufijtë globalë mbi nivelet e detyrimeve të tij. Kjo nuk i lejon ndërmarrjes amë që të ofrojë udhëzime në lidhje me operacionet ditore dhe me vendimet individuale për ndërtimin apo avancimin e linjave të shpërndarjes, të cilat nuk tejkalojnë kushtet e planit të miratuar financiar, apo ndonjë instrument ekuivalent.

8. Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes monitorohet nga Rregullatori në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, në mënyrë që mos t'i shfrytëzoj avantazhet për çrregullimin e konkurrencës. Në veçanti, në rastet kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një ndërmarrje të integruar vertikalisht, ai nuk duhet të krijojë konfuzion gjatë komunikimit dhe shfrytëzimit të shenjave identifikuese, sa i përket identitetit të ndarë të degës së furnizimit dhe ndërmarrjes së integruar vertikalisht.

9. Në rastet kur bazuar në raportin e dorëzuar, apo në informatat tjera, Rregullatori nuk është i bindur se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është duke vepruar plotësisht në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3. dhe 8. të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'ia ofrojë Rregullatorit në një afat sa më të shkurtër, të gjitha informatat tjera që mund të kërkohen prej saj. Në rastet kur konsiderohet i domosdoshëm sigurimi i pajtueshmërisë me paragrafet 3. dhe 8. të këtij neni, Rregullatori ndërmerr çfarëdo veprime tjera të nevojshme për të siguruar pajtueshmëri me këto dispozita përkatëse dhe me licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

**Neni 28**
**Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. Përgjegjësitë dhe të drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë:

1.1. operimi i sistemit të shpërndarjes;

1.2. sigurimi i funksionimit të koordinuar të sistemit të shpërndarjes të lidhur me rrjetet e operatorëve të tjerë dhe stabilimentet e shfrytëzuesve të rrjetit;

1.3. operimi i sistemit të shpërndarjes në mënyrë që të arrijë besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike dhe përdorimin ekonomik të rrjetit të shpërndarjes;

1.4. ofrimi i kyçjeve në rrjetin e shpërndarjes në pajtim me këtë ligj, për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit që kërkojnë një lidhje të tillë, në pajtim me kërkesat për kyçje të përcaktuara në Kodin e rrjetit të shpërndarjes;

1.5. sigurimi i qasjes në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve rregulluese, transparente dhe jodiskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit apo kategorive të shfrytëzuesve të sistemit, në veçanti duke mos i favorizuar vartësit apo aksionarët e tij;

1.6. të veprojë në pajtim me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe sigurisë së sistemit të shpërndarjes të cilat miratohen nga Rregullatori;

1.7. të sigurojë që në rastet e situatave emergjente të përcaktuara në ligjin për energji, ndërprerja e furnizimit bazohet në kritere të parapërcaktuara, jodiskriminuese dhe transparente;

1.8. t'i jep  prioritet dispeçimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe bashkëprodhimi, me kusht që të mos i tejkalojë limitet e sigurisë së sistemit, të specifikuara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes;

1.9. caktimi dhe publikimi i rregullave standarde mbi bartjen e shpenzimeve për adaptime teknike në sistemin e vet shpërndarës, siç janë kyçjet në rrjet apo përforcimet e rrjetit, që janë të domosdoshme për të integruar në sistem stabilimentet e reja të prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit që kyçen në rrjetin shpërndarës. Këto rregulla duhet të jenë në pajtim me Strategjinë për Energji dhe do të bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke marrë veçanërisht në konsideratë, të gjitha shpenzimet dhe përfitimet e ndërlidhura me kyçjen e prodhuesve të tillë në sistem. Këto rregulla i paraqiten  për miratim Rregullatorit;

1.10. sigurimi i të gjithë prodhuesve të rinj që duan të lidhen në rrjetin e sistemit të shpërndarjes me përshkrime gjithëpërfshirëse dhe të detajuara të shpenzimeve të ndërlidhura me kyçjen. Për këtë shërbim Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të kërkojë një pagesë që pasqyron kosto të arsyeshme;

1.11. përcaktimi dhe publikimi i rregullave dhe standardeve sa i përket ndarjes së shpenzimeve, për instalime në sistem siç janë kyçjet në rrjet dhe përforcimet e rrjetit, mes të gjithë shfrytëzuesve të sistemit që përfitojnë nga sistemi. Këto rregulla i dorëzohen për miratim Rregullatorit, në pajtim me Strategjinë për Energji dhe të gjitha aktet tjera nënligjore të zbatueshme;

1.12. hartimi i  metodologjive tarifore për qasje dhe kyçje në sistemin e shpërndarjes dhe aplikimin e tarifave për shfrytëzim të rrjetit të shpërndarjes dhe taksave për kyçje, sipas parimeve transparente dhe jodiskriminuese, që ofrojnë sinjale efikase ekonomike për shfrytëzuesit e sistemit. Metodologjitë, tarifat, taksat dhe metodologjia e llogaritjeve miratohen nga Rregullatori dhe publikohen në faqen elektronike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara datës së fillimit të  aplikimit, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

1.13. ofrimi i të dhënave nga pikat matëse komerciale të prodhuesve dhe furnizuesve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes, për nevoja të llogaritjes së barazimit përfundimtar;

1.14. sigurimi i disponueshëmrisë së kapaciteteve të shpërndarjes për shpërndarjen e energjisë elektrike për konsumatorët dhe  prodhuesit e kyçur në rrjetin e shpërndarjes;

1.15. dhënia e informacioneve ndërmarrjeve të energjisë dhe shfrytëzuesve të rrjetit të shpërndarjes, të nevojshme për qasje efektive në rrjet dhe shfrytëzim të rrjetit të

shpërndarjes, në mënyrë transparente dhe jodikriminuese;

1.16. krijimi dhe mirëmbajtja e një regjistri të konsumatorëve në nevojë;

1.17. sigurimin e informacioneve për parashikimin e kërkesave për energji elektrike dhe informacione tjera të kërkuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, Ministria apo Rregullatori;

1.18. zbatimi i masave për të përmirësuar efiçiencën e shpërndarjes së energjisë;

1.19. mbrojtja e mjedisit;

1.20. arritja e marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve ndihmëse me Operatorin e Sistemit të Transmetimit me qëllim të realizimit të shërbimeve të sistemit të Transmetimit;

1.21. sigurimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit;

1.22. arritja e marrëveshjeve me shfrytëzuesit e rrjetit të shpërndarjes për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për të realizuar, shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes në mënyrë ekonomike dhe efikase;

1.23. mirëmbajtja e regjistrit të pikave matëse për çdo palë përgjegjëse për jobalanc në pikat e livrimit në rrjetin e shpërndarjes;

1.24. analiza e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes në baza vjetore, duke përfshirë vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimi dhe zbatimi i masave për reduktimin e humbjeve;

1.25. përgatitja brenda vitit aktual, e planit vjetor të humbjeve të shpërndarjes për vitin vijues dhe dorëzimi për miratim te Rregullatori. Plani vjetor i humbjeve përfshin vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike;

1.26. zhvillimi i planeve dhjetë (10) vjeçare në harmoni me planin dhjetë (10) vjeçar zhvillimor të rrjetit të transmetimit, që duhet të miratohet nga Rregullatori, dhe përmbushja e detyrimeve që dalin nga këto plane;

1.27. zhvillimi i planit pesë (5) vjeçar për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes brenda vitit aktual për periudhën pesë (5) vjeçare që duhet të jetë në harmoni me planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes, me dokumentacionin e planifikimit hapësinor dhe me planin pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, i cili duhet të miratohet nga Rregullatori;

1.28. përpilimi brenda vitit aktual i Planit investiv një (1) vjeçar për vitin e ardhshëm, i cili miratohet nga Rregullatori, në pajtim me Planin dhjetë (10) vjeçar dhe Planin pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes dhe me dokumentacionin e planifikimit hapësinor;

1.29. mirëmbajtja e sistemeve matëse, mbledhja dhe procesimi i të dhënave nga pikat

matëse komerciale të shfrytëzuesve të rrjetit, në përputhje me këtë Ligj dhe Kodin e Matjes;

1.30. mbështesë komunat në përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive zhvillimore lokale për çështjet që ndikojnë në sistemin e shpërndarjes;

1.31. vënia në dispozicion për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të kopjeve të planeve zhvillimore pesë (5) vjeçare dhe dhjetë (10) vjeçare për sistemin e shpërndarjes;

1.32. pajtueshmëria e të gjitha veprimeve me Kodin e rrjetit të transmetimit, Kodin e rrjetit të shpërndarjes dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera në fuqi.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i raporton Rregullatorit, siç përcaktohet në licencën e tij dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, dhe i ofron asaj informata mbi çështjet siç mund t'i kërkohen, në formën dhe intervalet kohore të përcaktuara prej saj.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes iu ofron informata njësive të qeverisjes lokale për nevoja të tyre për zhvillimin e planeve zhvillimore lokale duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave të përdoruesve individualë të rrjetit.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton dhe rregullisht rishikon Kodin e rrjetit të shpërndarjes për sistemin e tij, në konsultim përkatës me operatorët e sistemeve të tjera, me të cilët është i lidhur dhe, me ndryshimet e mundshme, i dorëzon për miratim Rregullatorit.

5. Kodi i rrjetit të shpërndarjes duhet të përmbajë çështjet që mund t'i specifikojë Rregullatori, të cilat përfshijnë:

5.1. rregullat minimale për zhvillimin dhe operimin e sistemit të shpërndarjes, përfshirë obligimet për mirëmbajtjen në nivelin e duhur të sistemit të sigurisë dhe të kapacitetit rezervë;

5.2. rregullat teknike që përcaktojnë kriteret minimale për dizajnin teknik dhe atë operacional për kyçje me sistemin e transmetimit dhe interkoneksionit, si dhe operimin e sistemeve tjera;

5.3. procedurat e aplikueshme për operatorët e sistemit në situata emergjente.

6. Kodi i rrjetit të shpërndarjes bazohet në parimet objektive, jodiskriminuese dhe ndëroperuese me sistemet tjera dhe duhet aplikuar dhe bërë publik bazuar në ato parime.

7. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e Kodit i rrjetit të shpërndarjes dhe mbi implementimin e tij raporton në baza vjetore te Rregullatori.

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë të faturojë dhe inkasojë pagesat në pajtim me kontratat për shfrytëzimin e sistemit të tij si dhe për të gjitha shërbimet tjera të ofruara. Afatet dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat, për ofrimin e shërbimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktohen në mënyrë jodiskriminuese, që pasqyrojnë kostot dhe dorëzohen për miratim te Rregullatori. Pas miratimit nga Rregullatori ato bëhen publike.

9. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes blen energjinë e nevojshme për operim efikas të sistemit

të tij të shpërndarjes, si dhe mirëmbajtjet apo shërbimet tjera të duhura, në pajtim me procedurat transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg.

**Neni 29**

**Informatat konfidenciale**

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm afarist që merr gjatë kryerjes së aktivitetit të tij si dhe duhet të parandalojë informacionet mbi aktivitetet e tij që mund të krijojnë përparësi komerciale nëse zbulohen në mënyrë diskriminuese.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i raporton Rregullatorit, siç përcaktohet në licencën e tij dhe Ligjin e Rregullatorit për Energji dhe i ofron asaj informata mbi çështjet që mund të kërkohen, në formën dhe intervalet kohore të përcaktuara prej saj.

3. Pavarësisht paragrafit 1. të këtij neni, Ministria ose Rregullatori mund t'i kërkojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që t'iu ofrojë informacion konfidencial i cili është i domosdoshëm për t'i kryer funksionet, autorizimet dhe detyrat e tyre.

**Neni 30**

**Sistemet e mbyllura të shpërndarjes**

1. Rregullatori miraton rregullat për kryerjen e veprimtarisë së shpërndarjes brenda një sistemi të mbyllur të shpërndarjes.

2. Rregullatori mund ta lirojë Operatorin e Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes nga:

2.1. detyrimi për të blerë energjinë që e përdorë për të mbuluar humbjet e energjisë elektrike dhe kapacitetin rezervë në sistemin e vet në bazë të procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;

2.2. detyrimi që çmimet gjegjësisht kompensimet ose metodologjitë në të cilat mbështetet llogaritja e tyre të jenë aprovuar para hyrjes në fuqi nga Rregullatori.

3. Nëse zbatohet lirimi nga detyrimet siç përcaktohet në paragrafin 2. të këtij neni, çmimet ekzistuese gjegjësisht kompensimet ose metodologjia mbi të cilën janë bazuar llogaritjet, mund të rishikohen dhe të përshtaten me metodologjinë dhe çmimet e miratuara nga Rregullatori pas një kërkese të shfrytëzuesit të atij rrjeti.

4. Përdorimi i rastësishëm nga një numër i vogël i familjeve apo asociacioneve të ngjashme me të punësuar tek pronari i sistemit të distribucionit dhe të vendosur në zonën e shërbimit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes nuk përbënë përjashtim siç përcaktohet në paragrafin 2. të këtij neni.

**Neni 31**

**Shthurja dhe transparenca e llogarive**

1. Ndërmarrjet e Energjisë që kryejnë aktivitete të rregulluara të energjisë duhet të ndajnë llogaritë e tyre të brendshme për këto aktivitete në formë të tillë sikur këto aktivitete të zhvilloheshin nga ndërmarrje të veçanta me qëllim që të shmanget diskriminimi, subvencionet e ndërsjella dhe

shtrembërimi i konkurrencës. Ato gjithashtu duhet të mbajnë llogari , të cilat mund të jenë të konsoliduara , për aktivitete tjera të energjisë elektrike jo të rregulluara.

2. Të gjitha ndërmarrjet e energjisë duhet të kenë llogaritë e ndara për aktivitetet e licencuara të tyre dhe për të gjitha aktivitetet tjera dhe duhet të sigurojnë se këto llogari janë audituar. Kur është e përshtatshme, ata do të mbajnë llogari të konsoliduara për, aktivitetet e tjera jo energjetike.

## KAPITULLI VI
## TREGTIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FURNIZIMI

### Neni 32
### Tregtimi i energjisë elektrike

1. Tregtimi i energjisë elektrike është veprimtari e pavarur nga veprimtaria e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ka të bëjë me blerjen dhe shitjen, duke përfshirë edhe rishitjen, e energjisë elektrike konsumatorëve në tregun me shumicë, përfshirë edhe ata me obligime të shërbimit publik.

2. Tregtimin e energjisë elektrike mund të kryejnë ndërmarrjet e energjisë elektrike në bazë të licencës të lëshuar nga Rregullatori, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe në harmoni me Rregullat e Tregut.

3. Licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të njihen në Kosovë. Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike pa pasur nevojë për licencë shtesë. Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimin dhe rregullat fiskale.

### Neni 33
### Kryerja e veprimtarisë së furnizimit

1. Furnizimi me energji elektrike është aktivitet i pavarur nga aktiviteti i transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike dhe ka të bëjë me blerjen, shitjen, duke përfshirë edhe rishitjen e energjisë elektrike te konsumatorët.

2. Furnizimi mund të kryhet nga ndërmarrje të energjisë të licencuar nga Rregullatori për të kryer aktivitete të furnizimit.

3. Furnizuesit mund të furnizojnë me energji elektrike të gjithë konsumatorët brenda dhe jashtë Kosovës.

4. Furnizuesit me obligim të shërbimit publik duhet të ofrojnë furnizim me energji elektrike:

4.1. konsumatorëve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit brenda kuadrit të shërbimit universal në masën që kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet brenda kushteve të tregut;

4.2. konsumatorëve fundorë që e humbin furnizuesin e tyre të energjisë elektrike për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tyre për një periudhë jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë siç përcaktohet në nenin 39 të këtij ligji.

5. Të gjithë furnizuesit blejnë energji elektrike për furnizimin e konsumatorëve të tyre fundorë në tregun bilateral dhe në tregun e organizuar, me çmime të parregulluara. Përkundër kësaj Rregullatori mund të imponojë detyrim të shërbimit publik për prodhuesit e energjisë që të shesin energjinë furnizuesve me obligime të shërbimit publik për periudhë të kufizuar kohore. Vendimi i Rregullatorit duhet të jetë i arsyetuar, të publikohet si dhe të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

**Neni 34**
**Obligimet e furnizuesit**

1. Furnizuesi ka për obligim:

1.1. të bëj marrëveshje për qasjen në sistem me operatorin e sistemit në të cilin janë lidhur stabilimentet e konsumatorëve të tij; dhe

1.2. të bëjë marrëveshje që përcakton përgjegjësinë e balancimit në emër të:

1.2.1. konsumatorëve familjar dhe ndërmarrjeve të vogla;

1.2.2. konsumatorëve të mëdhenj jofamiljar për të cilët furnizuesi ka marrë këto përgjegjësi.

2. Furnizuesi duhet të informojë konsumatorin e tij:

2.1. në mënyrë të qartë dhe transparente mbi çmimet në fuqi, kushtet standarde dhe afatet për shfrytëzimin e shërbimeve të tij;

2.2. për mënyrat e ndryshme të pagesave që nuk bëjnë diskriminim në mes konsumatorëve. Sistemet e parapagimit duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë në masë adekuate konsumin e mundshëm. Secili dallim në kushte dhe afate duhet të reflektojë shpenzimet e furnizuesit në lidhje me sistemet e ndryshme të pagesës;

2.3. për të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe ndërruar furnizuesin pa pagesë;

2.4. për mundësinë e shfrytëzimit të procedurave të thjeshta dhe efektive në kosto për trajtimin e ankesave, si dhe secili furnizues duhet të sigurojë që konsumatorët e tij të kenë të drejtë për një standard të mirë të shërbimit dhe trajtim të ankesave me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, brenda tre (3) muajve;

2.5. për konsumin aktual të energjisë elektrike dhe shpenzimet saktësisht, për t'i mundësuar atyre të menaxhojnë konsumin e tyre të energjisë elektrike. Këto informata duhen ofruar brenda një afati të arsyeshëm që merr parasysh funksionet e njehsorëve elektrikë të instaluar, me vëmendjen e duhur ndaj shpenzimeve të atyre masave, si dhe pa ngarkuar konsumatorët fundorë me shpenzime shtesë për atë shërbim;

2.6. mbi ndryshimet e kushteve të kontratës së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit të tyre, duke përfshirë informatat për të drejtën e tyre të tërheqjes kur jepet njoftimi i tillë. Furnizuesit njoftojnë konsumatorët drejtpërdrejt për çfarëdo rritje në shpenzime, si dhe i informojnë ata që kanë të drejtë të tërhiqen nga kontratat nëse nuk i pranojnë kushtet e reja që janë ofruar sipas njoftimit;

2.7. me fatura dhe në materialet promvuese që i ofrohen konsumatorëve fundorë në lidhje me:

2.7.1. kontributin e secilit burim të energjisë në përzierjen e përgjithshme të lëndëve djegëse të furnizuesit në vitin paraprak në një mënyrë të kuptueshme, si dhe në nivel shtetëror, në mënyrë qartësisht të krahasueshme;

2.7.2. së paku referenca ndaj burimeve ekzistuese të informacionit, si faqet e internetit, ku gjendet informata për ndikimin mjedisor, në kuptimin së paku të emisioneve të $CO_2$ dhe mbetjeve radioaktive që pasojnë nga energjia elektrike e prodhuar me përzierjen e përgjithshme të lëndëve djegëse gjatë vitit të kaluar nga furnizuesi;

2.7.3. të drejtat e tyre në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që është në dispozicion në rast mosmarrëveshje;

2.7.4. për të dhënat e konsumit të tyre, si dhe t'i mundësojnë atyre, me pajtim të shprehur dhe pa pagesë, që t'i japin ndërmarrjes së regjistruar të furnizimit qasje në të dhënat e matjes;

2.7.5. për obligimin e tyre të pagesës përfundimtare duke i dërguar konsumatorëve llogarinë përfundimtare përmbyllëse pas secilit ndërrim të furnizuesve të energjisë elektrike jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pasi ndërrimi i furnizuesit të jetë bërë efektiv;

2.7.6. për sa i përket nën-paragrafeve 2.7.1 dhe 2.7.2 të këtij neni në lidhje me energjinë elektrike të siguruar nga furnizuesi nëpërmjet shkëmbimeve të energjisë elektrike apo importeve nga ndërmarrjet e vendosura jashtë Komunitetit të Energjisë, shifrat totale të siguruara nëpërmjet shkëmbimit të ndërmarrjet e cekura mund të përdoren ato të vitit të kaluar;

2.8. Furnizuesi gjithashtu duhet:

2.8.1. të publikojë dhe të mbajë parametra cilësorë, të kontraktuar të furnizimit me energji elektrike për konsumatorë, në pajtim me rregullat e cilësisë së furnizimit të miratuar nga Rregullatori;

2.8.2. të furnizojë konsumatorët me energji elektrike sipas kontratës së nënshkruar;

2.8.3. të mbajë të dhëna të ndara në regjistrat afaristë për furnizimin e konsumatorëve me çmime të parregulluara, si dhe furnizimit të konsumatorëve me çmime të rregulluara për furnizim, në kuadër të shërbimit universal si dhe furnizim të garantuar të konsumatorëve;

2.8.4. përcaktojnë kushtet e furnizuesit dhe t'i bëjë ato publike në mënyrën e duhur, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para fillimit të aktiviteteve të furnizimit me energji elektrike;

2.8.5. të ndërmarrë aktivitetin energjetik të furnizimit në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase;

2.8.6. në bashkëpunim me Rregullatorin, t'i ofrojë konsumatorit një kopje të listave kontrolluese të konsumatorit të energjisë elektrike, të përcaktuar nga Komisioni Evropian dhe të miratuar nga Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë i Komunitetit të Energjisë;

3. Para fillimit të furnizimit secili furnizues gjithashtu ka obligim të:

3.1. lidhë kontratë për balancim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose të lidh kontratë anëtarësimi në grupin e balancimit me udhëheqësin e këtij grupi në përputhje me Rregullat e Tregut;

3.2. lidhë kontratë për blerje të energjisë elektrike me së paku një furnizues tjetër, furnizues ose prodhues si dhe të lidhë kontratë për furnizim me konsumatorin fundor dhe, nëse është e nevojshme, të sigurojë kapacitete transmetuese ndërkufitare.

4. Furnizuesi me obligime të shërbimit publik të furnizimit të konsumatorve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal, duhet të krijojë mekanizmat e nevojshëm për përkrahjen e konsumatorve në nevojë, pas konsultimit me Rregullatorin, në mënyrë që të shmangen shkyçjes për mospagesë të faturave të energjisë elektrike.

5. Rregullatori duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se informatat e ofruara nga furnizuesi për konsumatorët e tij janë të besueshme dhe lehtë të krahasueshme.

6. Kërkesat mbi formën, llojin dhe shumën e garancisë financiare që palët tregtare duhet të dorzojnë përcaktohet në Rregullat e Tregut.

7. Furnizuesi mund të furnizojë nëpërmjet një pajisjeje matëse, për hapësirat e përbashkëta, vetëm nëse një person fizik a juridik nënshkruan kontratë me të dhe pranon të paguajë për të gjithë kapacitetin, energjinë elektrike, shërbimet e shpërndarjes dhe shërbimet e transmetimit të furnizuara përmes asaj pajisjeje matëse. Rregullatori mund të rregullojë afatet e kushtet sipas të cilave bëhet pagesa nga personi që merr përsipër pagesën në emër të shfrytëzuesve të hapësirës së përbashkët si dhe mund të vë taksa për personat të tjerë të cilët përfitojnë nga ajo energji elektrike.

8. Çdo person që kyçet në sistemin e shpërndarjes dhe shfrytëzon energjinë elektrike pa pasur kontratë me furnizuesin, shkyçet nga sistemi i shpërndarjes në pajtim me rregullat mbi shkyçjet të përcaktuara nga Rregullatori.

**Neni 35**

**Ruajtja e regjistrave**

1. Çdo tregtar i energjisë elektrike është i obliguar të vë në dispozicion të Rregullatorit, Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, institucioneve tjera relevante në Komunitetin e Energjisë apo të Bashkimit Evropian,

të cilat janë të bazuara në marrëveshjet ndërkombëtare të autorizuara apo të nevojshme për të kryer detyrat përkatëse, të dhënat relevante për pesë (5) vjet që kanë të bëjnë me të gjitha transaksionet kontraktuale për shitblerjen e energjisë në tregun me shumicë dhe me Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose Operatorin e Tregut duke përfshirë tregun financiar të derivativës.

2. Të dhënat përkatëse nga paragrafi 1. i këtij neni përfshijnë detaje të karakteristikave të transaksioneve relevante, përfshirë kohëzgjatjen dhe kushtet e livrimit, sasinë, datat, dhe kohën e ekzekutimit dhe çmimet e transaksionit dhe informatat tjera të nevojshme.

3. Rregullatori mund të vendosë që të vë në dispozicion, për pjesëmarrësit e tregut, elementet e informatave të tilla me kusht që mos të shpalosen informatat sensitive të pjesëmarrësve individual të tregut ose transaksioneve individuale.

**Neni 36**

**E drejta për ndërrimin e furnizuesit**

1. Çdo konsumator fundor, familjar ose jofamiljar, ka të drejtë të ndërrojë furnizuesin e tij.

2. Rregullatori miraton rregullat për ndërrim të furnizuesit. Procesi i ndërrimit të furnizuesit duhet të kryhet brenda njëzet e një (21) ditësh nga momenti i njoftimit të furnizuesit të deritashëm për vendimin e ndërrimit të furnizuesit. Këto rregulla duhet të përmbajnë:

2.1. procedurat e ndërrimit të furnizuesit;

2.2. kushtet që duhet t'i plotësojë furnizuesi i ri, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë së balancimit në pajtim me rregullat e balancimit të sistemit të energjisë elektrike;

2.3. detyrimet e furnizuesit i cili ndërpret kontratën me konsumatorin që kërkon ndërrimin e furnizuesit;

2.4. detyrimet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ku është i kyçur konsumatori;

2.5. të drejtat dhe obligimet e furnizuesit të ri në pikëpamje të qasjes në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të operatorit të sistemit ku është kyçur konsumatori që kërkon ndërrimin e furnizuesit;

2.6. të drejtat e furnizuesit në raport me konsumatorin e deritashëm, në pikëpamje të rregullimit të të gjitha detyrimeve të deritashme;

2.7. rregullimi i detyrimeve paraprake financiare dhe detyrimeve tjera të konsumatorit fundor;

3. Me rregullat për ndërrimin e furnizuesit duhet të përcaktohet edhe:

3.1. procedurat e ndërrimit të furnizuesit në kushtet e furnizimit të garantuar me energji;

3.2. procedurat e ndërrimit të furnizuesit me rastin e ndërrimit të pronësisë mbi ndërtesën;

3.3. procedurat e ndërrimit të raporteve kontraktuale në rastin e bartjes së përkohshme të kontratës për furnizim të konsumatorit fundor dhe kontratës për shfrytëzim të rrjetit të konsumatorit fundor në personin e tretë.

4. Ndërrimi i furnizuesit në pajtim me rregullat për ndërrimin e furnizuesit është pa pagesë për konsumatorin. Ndërrimi i furnizuesit bëhet me kërkesë të konsumatorit përveç kur kemi të bëjmë me furnizimin e garantuar.

5. Furnizuesi që është në procesin e shkëputjes së kontratës me konsumatorin, nuk mund të vendos kushte shtesë për shkëputjen e kontratës për furnizim me energji për konsumatorin fundor, përfshirë edhe pagesën e mbetur të konsumatorit fundor si dhe është i detyruar të furnizojë konsumatorin fundor deri në përfundim të procedurës së ndërrimit të furnizuesit. Përjashtim nga dispozita e mësipërme vendosja e kushteve shtesë bëhet vetëm në rast kur konsumatori fundor nuk ka kryer detyrimet, pas vërejtjes paraprake të furnizuesit, që për shkak të mosplotësimit të detyrimeve të mëparshme, gjegjësisht të arrijë marrëveshje në afat që nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ( 8) ditë nga dita e vërejtjes.

6. Rregullatori mbikëqyrë zbatimin e rregullave të ndërrimit të furnizuesit.

7. Në lidhje me kontestet, që shfaqen me rastin e ndërrimit të furnizuesit, vendos Rregullatori. Kundër vendimit të Rregullatorit nuk mund të shtrohet ankesë, por kontesti mund të zgjidhet në gjykatën kompetente. Pavarësisht kësaj procedure, procedura e ndërrimit të furnizuesit nuk mund të ndërpritet.

8. Për ndërrimin e furnizuesit, konsumatori nuk ngarkohet me detyrime të pagesës për procedurat e ndërrimit të furnizuesit.

## Neni 37
## Furnizimi me energji elektrike në kuadër të shërbimit universal

1. Për të siguruar ofrimin e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, Rregullatori mund të ngarkojë me obligime të shërbimit publik cilindo furnizues sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara me nenin 5 të këtij Ligji, duke obliguar atë që të ofrojë furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal. Këto obligime duhet të vendosen në licencën e të ngarkuarit me obligime të shërbimit publik.

2. Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar dhe jofamiljar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë së dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë së pesëdhjetë (50) punonjës.

3. Në rast se synimet e shërbimit universal nuk mund të arrihen në kushte të tregut, Rregullatori mund të rregullojë çmimet e energjisë elektrike të blerësve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, me kusht që të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafët 4. deri 8. të këtij neni.

4. Në rastet kur Rregullatori rregullon çmimin e energjisë elektrike për blerësit fundorë, ajo duhet të ofrojë një shpjegim dhe arsyetim të hollësishëm, duke ndërlidhur rregullimin e tillë me rrethanat e jashtëzakonshme në tregun e energjisë elektrike, si dhe duke ofruar një arsyetim të domosdoshmërisë së ruajtjes së rregullimit të çmimit të energjisë elektrike të konsumatorëve fundorë si obligim i shërbimit publik që është në përputhje me kushtet e këtij neni.

5. Rregullatori siguron që kategoritë e ndryshme të konsumatorëve të mos përfitojnë nga i njëjti trajtim dhe mbrojtje, si dhe që rregullimi i çmimit të konsumatorit fundorë me të drejta të furnizimit si shërbim universal të jetë në dispozicion vetëm për të siguruar ofrimin e shërbimit universal për konsumatorë familjar dhe ata jofamiljar që gëzojnë këtë të drejtë.

6. Rregullatori siguron që çmimet e energjisë elektrike që i nënshtrohen rregullimit, për qëllim të sigurimit të shërbimit universal, të reflektojnë koston. Reflektimi i kostos duhet të mbulojë koston reale të furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë koston e prodhimit, koston e balancimit, koston margjinale afatshkurtër, duke reflektuar portofolin e plotë të prodhimit, investimet e domosdoshme shkallën e duhur të kthimit, koston e importeve, koston e shërbimeve të furnizimit, si dhe borxhet e këqija.

7. Në vendimin e saj për rregullimin e çmimeve për konsumatorët fundorë, Rregullatori përcakton një datë të fundit për heqjen e rregullimit të çmimeve të blerësve fundorë, si dhe një plan veprimi për ta kryer këtë, duke shfaqur qartë natyrën e përkohshme të rregullimit të çmimeve të konsumatorëve fundorë.

8. Rregullatori bën rishikimet vjetore të metodologjive dhe nivelit të miratuar të çmimeve për konsumatorë fundorë, si dhe ekzistencës së domosdoshmërisë së rregullimit të çmimit për kategori të caktuara të blerësve në bazë të objektivit të shërbimit publik të ndjekur. Këto rishikime i dorëzohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, i cili, në bazë të analizës së tregut rajonal, mund të propozojë masa të tjera për heqjen e rregullimit të çmimeve për kategori të caktuara.

9. Për të siguruar furnizimin e garantuar mund të caktohet furnizuesi i mundësisë së fundit.

**Neni 38**
**Obligimet e furnizuesve me obligimin e shërbimit publik**

1. Përveç obligimeve tjera që kanë furnizuesit, furnizuesi me obligimin e shërbimit publik:

1.1. informon blerësit për të drejtat e tyre dhe kushtet e furnizimit në kuadër të shërbimit universal;

1.2. furnizon me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të përcaktuara në licencë;

1.3. furnizon me energji elektrike të një cilësie të caktuar në Rregulloren për cilësinë e furnizimit, të miratuar nga Rregullatori, brenda territorit për të cilin është caktuar të ofrojë furnizimin si shërbim universal;

1.4. faturon energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e arsyeshme, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese;

1.5. për aq kohë sa çmimet e energjisë elektrike të furnizuar nën obligimin e shërbimit publik janë të rregulluara nga Rregullatori, këto çmime duhen miratuar nga Rregullatori në pajtim me metodologjinë e miratuar prej saj. Furnizuesi duhet të publikojë tarifat në faqen e vet të internetit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit.

**Neni 39**
**Furnizimi i garantuar**

1. Furnizuesi i zgjedhur sipas nenit 40 të këtij ligji obligohet të furnizojë konsumatorët që ngelin pa furnizues në raste si në vijim:

1.1. furnizuesi i tij ka bankrotuar apo është në likuidim;

1.2. licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo ka pushuar së vlejturi;

1.3. konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

2. Furnizuesi që nuk është në gjendje të furnizojë energjinë elektrike tek konsumatori fundor në rastet e paragrafit 1.1. të këtij neni, do të obligohet të njoftojë furnizuesin e mundësisë së fundit, konsumatorin fundor, Rregullatorin dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes për datën e suspendimit të furnizimit në kohë të duhur. Në këtë rast, konsumatori menjëherë furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

3. Rregullatori informon furnizuesin e mundësisë së fundit, konsumatorin fundor, operatorët e sistemit të transmetimt dhe të shpërndarjes për furnizuesin sipas paragrafit 1.2. të këtij neni, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur licenca në fjalë ka pushuar të vlejë, ose nga hyrja në fuqi e Vendimit të Rregullatorit për revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të licencës.

4. Kontrata për furnizimin e garantuar për konsumatorë fundorë do të konsiderohet e lidhur në datën kur kushtet për ushtrimin e së drejtës për furnizim të garantuar, sipas nën-paragrafeve 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, të jenë përmbushur.

5. Furnizimi i garantuar në rastet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.3. të këtij neni, do të fillojë me ndërprerjen e kontratës me furnizuesin e mëparshëm ose kur furnizimi fillon për konsumatorin e ri, por që kontrata e furnizimit nuk është nënshkruar me ndonjë furnizues tjetër.

6. Furnizimi i garantuar nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

7. Në rast se konsumatori fundor nga nën-paragrafi 1.3. i këtij neni që është furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit dështon të hyjë në marrëveshje me furnizuesin e ri brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni, operatori i sistemit do ta ndërpresë furnizimin me energji elektrike.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i dorëzojnë informata furnizuesit të mundësisë së fundit mbi konsumatorët që janë transferuar tek furnizimi i garantuar brenda pesë (5) ditësh nga njoftimi në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni.

9. Çmimet me të cilat furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon me energji elektrike përcaktohen në bazë të metodologjisë së miratuar nga Rregullatori dhe do të jenë më të larta sesa çmimi mesatar i tregut ose sesa çmimi i furnizimit për konsumatorë të ngjashëm që furnizohen në treg, si dhe i përgjigjet çmimit të ofertës më të lirë të furnizimit në treg; derisa ekziston së paku një ofertë alternative e furnizimit, çmimi nuk duhet të tejkalojë shpenzimet e bëra me efikasitet në furnizim, në këtë rast, Rregullatori do të bazojë vendosjen e çmimeve tek krahasimi me

furnizues të krahasueshëm përtej kufijve.

10. Furnizuesi i mundësisë së fundit është i obliguar të njoftojë konsumatorin për kushtet dhe afatet e furnizimit dhe çmimin e energjisë elektrike, si dhe informon konsumatorin për të drejtën e tij për ndërrimin e furnizuesit. Ai duhet të publikojë këto kushte dhe informata në faqen e vet të internetit.

11. Furnizuesi i mundësisë së fundit i dorëzon kontratën konsumatorit fundor brenda tetë (8) ditësh nga fillimi i furnizimit.

12. Furnizuesi i mundësisë së fundit publikon në faqen e tij të internetit, së paku një herë në vit, informatat mbi numrin e konsumatorëve të furnizuar, sasinë totale të energjisë elektrike të livruar, periudhën mesatare të furnizimit, ndaras për konsumatorët familjar dhe ata jofamiljar që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal.

**Neni 40**

**Caktimi i furnizuesit të mundësisë së fundit**

1. Në bazë të një procedure të hapur tenderimi, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Vendimi për hapjen e procedurës së tenderimit sipas paragrafit 1. të këtij neni përmban kriteret për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit, kushtet dhe afatet për furnizimin e garantuar, informatat për formimin e çmimit dhe ndryshimet e tij, kushtet dhe afatet e kontratës, si dhe kohëzgjatjen e periudhës për të cilën caktohet furnizuesi i mundësisë së fundit.

3. Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë veprimi si furnizues i tillë prej tre (3) vitesh.

4. Në rast se nuk zgjidhet furnizuesi i mundësisë së fundit në periudhën e përcaktuar me paragrafin 1. të këtij neni, Rregullatori do të caktojë një furnizues që përkohësisht të ushtrojë funksionin e furnizuesit të mundësisë së fundit, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, periudhë kjo brenda të cilës do të zhvillohet tenderi i ri. Në rast se edhe tenderi i dytë dështon, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit me një akt të veçantë, duke përcaktuar të gjitha kushtet dhe afatet për vendosjen e obligimit të shërbimit publik në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.

**Neni 41**

**Obligimet e furnizuesve të mundësisë së fundit**

1. Përveç detyrimeve të furnizuesve tjerë, furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të:

1.1. furnizojë konsumatorët fundorë sipas nenit 39 të këtij Ligji derisa konsumatorët të zgjedhin furnizuesin sipas dëshirës, por jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë;

1.2. faturojë konsumatorët fundorë të përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji për energjinë elektrike të livruar, në pajtim me çmimet e furnizimit të garantuar, të miratuara nga Rregullatori në pajtim me metodologjinë e hartuar dhe miratuar nga Rregullatori;

1.3. informojë konsumatorët fundorë për kushtet e furnizimit të garantuar, ndërprerjen e kontratës për furnizim të garantuar dhe të drejtën e tyre për zgjedhjen e lirë të furnizuesit

të energjisë elektrike;

1.4. dorëzojë tek konsumatori fundor kontratën e furnizimit të garantuar jo më vonë se tetë (8) ditë nga fillimi i furnizimit.

**Neni 42**

**Mbrojtja ndaj veprimeve të furnizuesit me obligime të shërbimit publik**

1. Pala e pakënaqur me punën e furnizuesit me obligime të shërbimit publik të furnizimit si shërbim universal ose furnizuesit të mundësisë së fundit mund të shtroj ankesë te Rregullatori në formë të shkruar.

2. Ankesa nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me refuzimin e ofrimit të shërbimit universal të furnizimit të konsumatorit fundor, që gëzon të drejtë të furnizimit të kësaj forme, refuzimin e ofrimit të furnizimit të garantuar të konsumatorit fundor, aplikimin e metodologjisë për caktimin e çmimeve të energjisë elektrike në kuadër të shërbimit universal të furnizimit dhe aplikimin e metodologjisë për caktimin e çmimeve të energjisë në kuadër të shërbimit të furnizimit të garantuar.

3. Rregullatori është e obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e paraqitjes së ankesës, të njoftojë palën e pakënaqur në formë të shkruar për masat që ka ndërmarrë lidhur me ankesën. Nëse pala ankuese nuk pajtohet me masat e ndërmarra ose nuk është njoftuar brenda afatit për masat e ndërmarra mund të nisë proces gjyqësor.

**Neni 43**

**Linjat direkte**

1. Të gjithë prodhuesve dhe furnizuesve të energjisë elektrike në Kosovë u mundësohet furnizimi me energji elektrike për stabilimentet e tyre, filalave të tyre ose konsumatorëve fundorë nëpërmjet linjave direkte.

2. Të gjithë konsumatorët fundorë në Kosovë kanë të drejtën që të furnizohen nëpërmjet linjave direkte nga prodhuesi dhe furnizuesi.

3. Autorizimet për ndërtimin e linjave direkte lëshohen nga Rregullatori në bazë të kritereve objektive dhe jodiskriminuese, të publikuara paraprakisht, e që kanë të bëjnë me sigurinë, efikasitetin dhe integritetin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes. Rregullatori mund të refuzojë dhënien e autorizimit për ndërtimin e një linje direkte, nëse dhënia e autorizimit e parandalon ose pengon një detyrim të shërbimit publik të vendosur nga Rregullatori. Për një refuzim të tillë duhet të jepen arsye të besueshme.

4. Nëse një konsumator fundor pranon furnizim përmes linjës direkte, kjo nuk do të ndikojë në të drejtën e tij të kontraktimit të furnizuesit përmes sistemit të transmetimit ose sistemit të shpërndarjes në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## KAPITULLI VII
## QASJA E PALËS SË TRETË

### Neni 44
### Qasja e palës së tretë

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të lejojnë qasje palës së tretë në sistemin e transmetimit në bazë të metodologjisë tarifore të zhvilluar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe qasje e palës së tretë në sistemin e shpërndarjes në bazë të metodologjisë tarifore të zhvilluar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Metodologjitë tarifore pas miratimit nga Rregullatori publikohen në ueb- faqet e operatorëve përkatës.

2. Gjatë përcaktimit se në çfarë mase do të lejohen kërkesat për qasje në sistemin e Transmetimit apo të shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sigurojnë se e vënë në dispozicion kapacitetin maksimal të sistemeve të tyre, përfshirë interkonektorët, në pajtim me standardet e zbatueshme të sigurisë dhe nevojën për operim të sigurt të sistemit.

3. Tarifat për shfrytëzim të sistemit duhet të jenë objektive dhe aplikohen për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit në baza jodiskriminuese. Këto tarifa propozohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas mënyrës së përcaktuar nga Rregullatori, si dhe hyjnë në fuqi pas miratimit dhe publikimit nga Rregullatori. Tarifat e propozuara përfshijnë sinjale të duhura ekonomike për inkurajimin e përdorimit efiçient të sistemeve dhe interkonektorëve.

### Neni 45
### Refuzimi i qasjes të palës së tretë

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë qasjen në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes nëse nuk ka në dispozicion kapacitete të nevojshme, dhe nëse mungesa e kapaciteteve arsyetohet në mënyrë objektive në bazë të kritereve të arsyeshme teknike, duke pasur parasysh sigurinë e furnizimit, ose cilësisë së furnizimit, duke marrë parasysh standardet e shërbimit dhe besueshmërinë e kërkuar nga personi që kërkon qasje, si dhe të gjitha kodet dhe rregullat në fuqi.

2. Të gjitha arsyet për refuzim të qasjes sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të paraqiten në raportin me shkrim me faktet mbështetëse, dhe t'i jepet personit që kërkon të lidhë kontratë për qasje në sistem. Poashtu, personit që kërkon qasje duhet t'i ofrohen informata mbi masat e nevojshme për përforcimin e rrjetit për lejimin e qasjes, përveç kësaj operatori relevant i sistemit mund të kërkojë pagesë të arsyeshme që pasqyron kostot e ofrimit të informatave të tilla.

3. Çdo personi të cilit i refuzohet qasja në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes apo i cili kundërshton kushtet e imponuara për qasje, mund të parashtrojë ankesë te Rregullatori, e cila merr Vendim në përputhje me procedurat e parapara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

## KAPITULLI VIII
## KONSUMATORI FUNDOR

### Neni 46
### Kërkesat kontraktuale

1. Të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të furnizuesit të shërbimeve elektrike dhe konsumatorit i nënshtrohen një kontrate të bërë me shkrim dhe të nënshkruar.

2. Kontrata e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni përmban, përveç elementeve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, edhe elementet si në vijim:

2.1. identitetin dhe adresën e furnizuesit;

2.2. shërbimet e ofruara, duke përfshirë kohën e kyçjes fillestare dhe nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar;

2.3. llojet e shërbimit të mirëmbajtjes që ofrohet;

2.4. çfarëdo kompensimi dhe rregullat e rimbursimit të cilat aplikohen nëse nivelet e kontraktuara të cilësisë së shërbimit nuk përmbushen, duke përfshirë faturimin e pasaktë dhe të vonuar;

2.5. mënyrat në të cilat informatat e azhurnuara mbi të gjitha tarifat dhe shpenzimet e mirëmbajtjes mund të merren;

2.6. metodat e njoftimit të ndryshimeve të çmimeve dhe kushteve të shërbimit të energjisë elektrike;

2.7. kohëzgjatja e kontratës, kushtet për ripërtërirjen dhe ndërprerjen e kontratës, si dhe të drejtat dhe obligimet në rast të anulimit dhe ndërprerjes së marrëveshjes, duke përfshirë informatat nëse lejohet tërheqja nga kontrata pa pagesë;

2.8. metoda e inicimit të procedurave për zgjidhje të mosmarrëveshjeve;

2.9. informatat në lidhje me të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë ato mbi trajtimin e ankesave si dhe informatat e përmendura në këtë pikë, të komunikuara qartë përmes faturimit ose faqes së internetit të ndërmarrjes së energjisë elektrike;

2.10. të drejtat dhe obligimet e ofruesit të shërbimeve të energjisë elektrike dhe konsumatorit, në rast të dështimit në përmbushje të obligimeve të tyre si dhe në rast të suspendimit të përkohshëm të livrimit;

2.11. elemente të tjera varësisht nga karakteri i veçantë dhe lloji i shërbimeve të energjisë elektrike që ofrohen .

3. Kushtet dhe afatet dhe elementet tjera të lidhura me nënshkrimin e kontratës së shitjes rregullohen më hollësisht nga Rregullatori në Rregullat e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

4. Dispozitat e kontratës duhet të përmbajnë edhe të drejtat dhe obligimet e konsumatorit në gjuhë të qartë, të thjeshtë dhe pa dykuptimësi.

5. Informatat për kushtet e kontratës i duhen ofruar konsumatorëve shumë më herët, por në çdo rast, para përmbylljes së kontratës. Kushtet dhe afatet e përgjithshme duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato do të ofrohen në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe nuk duhet të përmbajnë pengesa jokontraktuale ndaj ushtrimit të të drejtës së konsumatorit, si dokumentacioni i tepërt kontraktor. Konsumatorët duhen mbrojtur nga metodat e padrejta apo mashtruese të shitjes.

6. Në rastet kur kontratat nënshkruhen përmes ndërmjetësve, informatat në lidhje me çështjet e përcaktuara në paragrafin 5. të këtij neni do të ofrohen gjithashtu edhe para hyrjes në kontratë.

7. Konsumatorët mund të hyjnë në më shumë se një kontratë për një pikë livrimi për të njëjtën periudhë të furnizimit.

8. Asgjë në kontratë nuk duhet të pengojë të drejtën e konsumatorit për të ndërruar furnizuesin, derisa kontrata nuk duhet të imponojë obligime financiare shtesë për atë konsumator që ushtron të drejtën e tij të ndërrimit të furnizuesit.

**Neni 47**
**Cilësia e furnizimit me energji**

1. Cilësia e furnizimit me energji elektrike përfshinë:

1.1. cilësinë e shërbimit;

1.2. furnizimin e pandërprerë;

1.3. cilësinë e tensionit.

2. Rregullatori përcakton kriteret e cilësisë së furnizimit me energji elektrike me të cilat përcaktohen:

2.1. treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

2.2. mënyra e matjes, grumbullimit dhe publikimit të treguesve të cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

2.3. ngjarjet e jashtëzakonshme në pikëpamje të cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

2.4. vendosjen shkallë shkallë të standardeve minimale të përgjithshme dhe atyre të garantuara të cilësisë së garantuar të furnizimit me energji elektrike;

2.5. mënyrën e rregullimit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në varësi nga metoda e përzgjedhur e rregullimit tarifor;

2.6. vendosjen shkallë shkallë të kompenzimeve financiare të konsumatorit fundor, pas

vendosjes së standardeve të cilësisë së garantuar të furnizimit me energji elektrike;

2.7. mënyrën, dinamikën dhe fushën e informimit si dhe dorëzimin e të dhënave Rregullatorit mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike;

2.8. përmbajtjen e raportit vjetor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike;

2.9. përmbajtjen e raportit vjetor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike;

2.10. përmbajtjen e raportit vjetor të furnizuesit mbi cilësinë e shërbimit të furnizimit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes obligohen që në pajtim me kushtet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike sistematikisht të:

3.1. ruajnë shkallën e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

3.2. përcjellin treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike si; dhe

3.3. udhëheqin me evidencën e të dhënave të nevojshme për vërtetimin e treguesve të cilësisë së energjisë elektrike.

4. Secili furnizues obligohet që në pajtim me kushtet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike sistematikisht të:

4.1. ruaj shkallën e cilësisë së shërbimit;

4.2. përcjellë treguesit e cilësisë së shërbimit si; dhe

4.3. mbajë evidencën e të dhënave të nevojshme për vërtetimin e cilësisë së shërbimit.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe secili furnizues, një herë në vit duhet të publikojnë raportet për cilësinë e furnizimit me energji elektrike si dhe të raportojë dhe dorëzojë të dhëna te Rregullatori në lidhje me cilësinë e furnizimit me energji elektrike.

**Neni 48**
**Mbrojtja e konsumatorit**

1. Konsumatori fundor gëzon mbrojtjen e të drejtave të tij në pajtim me këtë Ligj, aktet nënligjore të nxjerra sipas këtij Ligji, si dhe legjislacionin që rregullon mbrojtjen e konsumatorit.

2. Ndalohen sjelljet e pahijshme dhe të padrejta dhe aktivitetet mashtruese në kuptimin e mbrojtjes së konsumatorit, derisa kushtet dhe afatet e ofruara për nënshkrim të kontratës të jenë transparente dhe të shkruara në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.

3. Derisa kryen aktivitetet e punës së tij, furnizuesi duhet të veprojë në atë mënyrë që të sigurojë

pozitë të barabartë të konsumatorëve të energjisë elektrike.

4. Konsumatori ka të drejtë të:

4.1. marrë të gjitha informatat e përcaktuara sipas këtij ligji;

4.2. marrë njoftimin adekuat për synimin e modifikimit të kushteve të kontratës, si dhe informimin për të drejtën e tyre të tërheqjes kur jepet ai njoftim. Ofruesit e shërbimit i njoftojnë drejtpërdrejt konsumatorët e tyre, për çfarëdo rritje në shpenzime, në kohën e përshtatshme, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi rritja ka hyrë në fuqi, në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Konsumatorët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata nëse nuk i pranojnë kushtet e reja që iu njoftohen atyre nga ofruesi i shërbimit të energjisë elektrike;

4.3. pranojë informata transparente për çmimet dhe tarifat e vlefshme dhe kushtet e afatet standarde, në lidhje me qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;

4.4. marrë ofertën për një zgjedhje të gjerë të metodave të pagesës, të cilat nuk bëjnë diskriminim të paarsyeshëm mes konsumatorëve. Sistemi i parapagimit duhet të jetë i drejtë dhe të reflektojë në masë adekuate konsumin e mundshëm. Secili dallim në kushte e afate duhet të reflektojë shpenzimet e furnizuesit në sisteme të ndryshme të pagesës. Kushtet dhe afatet e përgjithshme duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato duhen ofruar në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme si dhe nuk do të përmbajnë barriera jokontraktuese ndaj ushtrimit të të drejtave të konsumatorit. Konsumatori duhet mbrojtur nga metodat e padrejta apo shtrembëruese të shitjes;

4.5. mos paguajë për ndërrimin e furnizuesit;

4.6. përfitojë nga procedurat transparente, të thjeshta dhe jo të shtrenjta në trajtimin e ankesave të tyre. Në veçanti, të gjithë konsumatorët duhet të kenë të drejtë për një standard të mirë të shërbimit dhe trajtimit të ankesave nga ofruesi i shërbimeve të energjisë elektrike. Procedurat e tilla të zgjidhjes jashtëgjyqësore të kontesteve mundësojnë zgjidhje të mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, brenda tre (3) muajsh, me ofrimin, aty ku kërkohet, e një sistemi të rimbursimit ose kompensimit;

4.7. kur ka qasje në shërbimin universal, të jetë i informuar për të drejtat e tij në lidhje me shërbimet universale;

4.8. ketë në dispozicion të dhënat e konsumit të tij, si dhe duhet të jetë në gjendje, me pajtim të shprehur dhe pa pagesë, t'i ofrojë ndërmarrjes së regjistruar të furnizimit qasje në të dhënat e njehsimit. Rregullatori përcakton formatin e të dhënave si dhe procedurën për furnizuesit dhe konsumatorët që të kenë qasje në të dhëna. Konsumatori nuk ngarkohet me shpenzime shtesë për atë shërbim;

4.9. të informohet mirë për konsumin aktual të energjisë elektrike dhe shpenzimet aq herë sa t'i mundësohet rregullimi i konsumit vetanak të energjisë elektrike. Ato informata ofrohen brenda një kornize kohore të mjaftueshme, e cila merr parasysh kapacitetin e pajisjeve matëse të konsumatorit dhe produktit elektrik në fjalë. Duhet të merret parasysh edhe efikasiteti në kosto i atyre masave. Konsumatori nuk ngarkohet me shpenzime shtesë për atë shërbim;

4.10. merr llogarinë përfundimtare të mbylljes pas ndërrimit të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas kryerjes së ndërrimit të furnizuesit.

5. Sisteme inteligjente të njehsimit që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e furnizimit me energji elektrike mund të vendoset duke pasur në konsideratë:

5.1. zbatimin e sistemeve të tilla të njehsimit apo matjes që i nënshtrohet një vlerësimi ekonomik të të gjitha shpenzimeve dhe përfitimeve afatgjate për tregun dhe konsumatorin individual, apo të formës së matjes inteligjente që është ekonomikisht e arsyeshme dhe efektive në kosto, si dhe afatit që është i arsyeshëm për shpërndarjen e tyre. Vlerësimi i tillë do të bëhet deri më 1 janar 2020. Sipas atij vlerësimi, Rregullatori përgatit një tabelë afatesh me cak deri në dhjetë (10) vjet për zbatimin e sistemeve inteligjente të matjes;

5.2. nëse instalimi i njehsorëve inteligjentë vlerësohet pozitivisht, së paku tetëdhjetë përqind (80%) e konsumatorëve do të pajisen me sisteme inteligjente të matjes deri më 2025.

6. Rregullatori siguron ndërveprimin e atyre sistemeve të matjes për zbatimin në territorin e saj, si dhe të marrë parasysh shfrytëzimin e standardeve përkatëse dhe praktikave të mira, si dhe rëndësinë e zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike.

7. Rregullatori duhet të sigurojë ofrimin e një pike të vetme kontakti për t'i furnizuar konsumatorët me të gjitha informatat e nevojshme në dispozicion , që lidhen me të drejtat e tyre, ligjin aktual dhe mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rast kontesti. Pika e tillë e kontaktit mund të jenë pjesë e pikave të informimit të përgjithshëm të konsumatorit.

8. Për trajtimin efikas jashtëgjyqësor të kontesteve duhet të funksionoj një organ për konsumatorin i cili i përgjigjet drejtpërsëdrejti Bordit të Rregullatorit.

**Neni 49**

**Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë**

1. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Rregullatorin dhe hisedarët tjerë në sektorin e energjisë elektrike, duhet të zhvillojë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë, fushëveprimit të të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike.

2. Programi i trajtimit të konsumatorëve në nevojë i përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni do të aprovohet nga Qeveria dhe do të përfshijë së paku një nga elementet në vijim:

2.1. caktimin e konsumatorëve në nevojë që përfitojnë nga programi i përcaktuar sipas këtij neni si:

2.1.1. nuk do të përfshijë më shumë se një pakicë të konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë;

2.1.2. do të jetë i kufizuar në konsumatorët e energjisë elektrike me të ardhurat më të ulëta që përdorin energji elektrike për furnizim për banimin e përhershëm,

ku për përcaktimin e të ardhurave të ulëta, përveç të ardhurave, do të merren parasysh të gjitha asetet në dispozicion.

2.2. do t'i bëhet referencë nivelit maksimal i konsumit të energjisë elektrike për person duke pasqyruar sezonën, kur përcaktohet niveli i konsumit të energjisë elektrike për person, do të merret parasysh konsumi total deri në treqind (300) KWh për një familje me deri katër (4) anëtarë;

2.3. mënyrën e mbështetjes së drejtpërdrejtë nga ana e Qeverisë për konsusmatorët në nevojë nga burime të tjera të të ardhurave ndryshe nga tarifat që i ngarkohen të licencuarit, për të shmangur ndërsubvencionet dhe shtrembërimin e çmimeve; dhe

2.4. financimi për mbështetje për konsumatorët në nevojë duhet të realizohet në mënyrë jodiskriminuese dhe në veçanti nuk duhet të financohet nga konsumatorët e energjisë elektrike.

3. Konsumatorët familjarë që përfitojnë nga mbështetja financiare për pagesat për shërbimin e furnizimit me energji elektrike nuk do të lejohen të shfrytëzojnë fondet e tilla për qëllime të tjera.

4. Konsumatorët familjar që kanë marrë vendim mbi statusin e tyre të konsumatorëve në nevojë sociale kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në përputhje me këtë ligj dhe me programin e zhvilluar sipas paragrafit 1. të këtij neni.

5. Konsumatorët në nevojë kanë të drejtë në shërbim të furnizimit sipas këtij neni për aq kohë sa janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, të cilat do të verifikohen të paktën çdo gjashtë (6) muaj nga autoriteti përgjegjës për mirëqenie sociale. Nëse, për shkak të ndryshimit të rrethanave, konsumatori humb statusin e konsumatorit në nevojë sociale, ai do të fshihet nga regjistri përkatës, por të dhënat e tij do të ruhen për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas regjistrimit të tij në regjistrin në fjalë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes njofton konsumatorin në nevojë dhe furnizuesin e tij, me shkrim dhe brenda tetë (8) ditëve, në lidhje me fshirjen e konsumatorit në nevojë nga regjistri përkatës.

6. Ndryshimi ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave nga aktiviteti i furnizuesit për konsumatorët në nevojë socialë të energjisë elektrike do të mbulohet nga Qeveria.

7. Furnizuesi në kuadër të detyrimeve të shërbimit publik është i detyruar të sigurojë kontratë të furnizimit për të gjithë konsumatorët në nevojë të energjisë elektrike dhe fillon furnizimin pa vonesë, pasi që konsumatori në nevojë të ketë dorëzuar kërkesë të shoqëruar me dëshmi për përmbushjen e kërkesave nga paragrafi 1. të këtij neni.

8. Operatorët e sistemit të shpërndarjes do të krijojnë dhe mirëmbajnë një regjistër të konsumatorëve në nevojë. Regjistri duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e konsumatorit në nevojë, numrin personal të identifikimit, adresën në të cilën ai furnizohet me energji elektrike, numrin nën të cilin ai është i listuar, llojin e trajtimit të veçantë për të cilin ai ka të drejtë dhe përfitimet që i dhurohen me statusin e konsumatorit në nevojë. Të dhënat nga regjistri mund t'i prezantohen vetëm konsumatorit në nevojë që ka aplikuar për regjistrim në regjistrin përkatës dhe furnizuesit të tij.

9. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me konsumatorët në nevojë, të përcaktuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, do të zbatohen dhe aplikohen në tërësi nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Në veçanti, operatori i sistemit të shpërndarjes do t'i marrë masat e duhura për t'i mbrojtur konsumatorët fundorë në zonat e largëta të cilët janë të lidhur në sistemin e energjisë elektrike.

10. Furnizuesi që ofron furnizim me energji elektrike për konsumatorët në nevojë krijon mekanizma për ofrimin e asistencës për konsumatorët në nevojë që kanë për qëllim shmangien e shkyçjes si pasojë e faturave të papaguara.

11. Bazuar në aktet ligjore në fuqi, masat e duhura si hartimi i planeve kombëtare të energjisë, do të merren në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve sociale për të siguruar furnizimin e nevojshëm me energji elektrike për konsumatorët në nevojë, apo sigurimin e mbështetjes për përmirësime të efiçiencës së energjisë, për trajtimin e varfërisë së energjisë, aty ku ajo identifikohet, duke përfshirë edhe në kontekst më të gjerë të varfërisë. Masat e tilla nuk do pengojnë hapjen efektive të tregut dhe funksionimin e tij, të rregulluar me këtë ligj, dhe të njëjtat njoftohen tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Njoftimet e tilla nuk përfshijnë masat e marra në kuadër të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve sociale.

**Neni 50**

**Obligimi i kyçjes së konsumatorit dhe prodhuesit**

1. Operatorët e sistemeve duhet të mundësojnë kyçjen në sistem të çdo konsumatori apo prodhuesi:

2. Pala që kërkon kyçjen duhet t'i përmbahet obligimeve:

   2.1. posedimi i pajisjeve ndërprerëse elektrike të instaluara brenda kufijve të pronës së tij e cila i përmbush kërkesat teknike dhe operacionale të sigurisë;

   2.2. plotësimi i kushteve për kyçje në sistemin e transmetimit apo shpërndarjes, përfshirë Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes, sipas kërkesës;

   2.3. nënshkrimi i marrëveshjes me shkrim me operatorin ku kërkon të kyçet përkitazi me kyçjen, duke përfshirë pagesën e rregulluar për kyçje dhe pagesën për shfrytëzim të sistemit, sipas nevojës;

   2.4. pagimi i të gjitha borxheve të papaguara të marrëveshjes për kyçje; dhe

   2.5. kur pala është konsumator, ofrimi i dëshmive të kënaqshme se ekziston kontrata e lidhur me furnizuesin për furnizimin me energji përmes kyçjes duke përfshirë përgjegjësinë e balancimit.

3. Kushtet dhe afatet për kyçje në sistemin e shpërndarjes apo të transmetimit duhet të bazohen në procedura efikase, transparente dhe jodiskriminuese për kyçje, të përcaktuara në Kodin e rrjetit të transmetimit apo Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes metodologjitë përkatëse për kyçje që miratohen nga Rregullatori dhe që publikohen nga operatorët përkatës.

**Neni 51**

**Refuzimi i kyçjes në sistem**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë kyçjen e një centrali të ri për arsye të kufizimeve të mundshme të kapaciteteve të rrjetit në dispozicion, siç mund të jetë kongjestioni në pjesët më të largëta të sistemit të transmetimit. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë informatat e domosdoshme për palën e interesuar.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të ketë të drejtë të refuzojë ndonjë pikë të re të kyçjes për arsye se kjo do të rezultonte me shpenzime shtesë që ndërlidhen me ngritjen e domosdoshme të kapaciteteve të elementëve të sistemit që ndodhen në afërsi të pikës së kyçjes.

3. Konsumatori ose prodhuesi i përcaktuar në nenin 58 të këtij ligji nuk ka të drejtë të kyçet në sistem, nëse nuk i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë. Konsumatori ose prodhuesi i cili është refuzuar ka të drejtë të ankohet kundër një Vendimi të tillë tek Rregullatori, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kyçin një konsumator ose prodhues pa vonesë deri në datën e përcaktuar nga Rregullatori në sistemin e tyre në rastet kur Rregullatori vendos mbi një ankesë në të mirë të konsumatorit ose prodhuesit në fjalë.

**Neni 52**

**Pezullimi dhe ndërprerja e përkohshme e furnizimit me energji elektrike**

1. Operatorët e sistemeve kanë të drejtë të pezullojnë përkohësisht furnizimin me energji elektrike në bazë të kushteve të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe rregullat mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji.

2. Operatorët e sistemeve kanë të drejtë të bëjnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët që nuk paguajnë detyrimet, në përputhje me kontratat me konsumatorët, rregullat e nxjerra nga Rregullatori, si dhe duke pasur parasysh vendimet e Rregullatorit që kanë të bëjnë me konsumatorët në nevojë dhe për t'iu shmangur ndërprerjeve gjatë sezonit të dimrit.

3. Furnizuesit duhet që ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve ta bëjnë në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Këto rregulla përfshijnë të drejtën e operatorëve për shkyçjen e konsumatorëve fundor të cilët:

3.1. nuk kanë nënshkruar kontratë me furnizuesin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi prej konsumatorit të një projekt kontrate të ofruar për nënshkrim;

3.2. janë duke pranuar energji elektrike në mënyrë të paautorizuar, në shkelje të dispozitave përkatëse të këtij ligji dhe Kodit Penal.

## KAPITULLI IX
## MATJA DHE FATURIMI

### Neni 53
### Pajisjet matëse

1. Energjia elektrike e dërguar tek konsumatori apo e plasuar në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes nga prodhuesit matet me pajisje matëse që duhet vendosur në kufi të sistemit të transmetimit apo sistemit të shpërndarjes me konsumatorët apo prodhuesit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes, të miratuar nga Rregullatori.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktojnë tipin, numrin dhe vendin e montimit të pajisjes matëse si dhe kontrollin përkatës dhe mënyrat e komunikimit. Gjatë përcaktimit të vendit të montimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurohen që qasja në njehsor të vihet në dispozicion për qëllime të mirëmbajtjes dhe leximit të pajisjeve matëse.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalojnë pajisjet matëse. Në rast se konsumatorëve ose prodhuesve u lejohet të zgjedhin llojin dhe tipin e pajisjes matëse, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet ta instalojnë pajisjen e tillë me kusht që të specifikohet me shkrim se një gjë e tillë është bërë në pajtim me Kodin e Matjes.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sigurojnë ndërveprimin e këtyre sistemeve të pajisjeve matëse që do të zbatohen dhe i kushtojnë kujdes të duhur standardeve dhe praktikave më të mira dhe rëndësisë së zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë.

5 Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas nevojës, në përputhje me Kodin e Matjes ofrojnë qasje në të dhënat e matjes për konsumatorin ose furnizuesin e tyre.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas nevojës, pas marrëveshjes me konsumatorin, ofrojnë qasje në të dhënat e njehsimit për konsumatorin apo furnizuesin e tij. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përkufizojnë formatin për të dhënat e njehsuara dhe procedurën që furnizuesit dhe konsumatorët të kenë qasje në këto të dhëna. Për këtë shërbim nuk ngarkohen kosto shtesë për konsumatorët.

### Neni 54
### Përdorimi i pajisjeve matëse

1. Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë.

2. Me kërkesë të shfrytëzuesit të sistemit dhe në llogari të tij mund të instalohet pajisja shtesë kontrolluese për matjen e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike.

3. Në rast të çfarëdo devijimi në matjet e dhëna nga mjetet sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, përtej nivelit të pranueshëm të pasaktësisë teknike, çështja do të zgjidhet në pajtim me procedurat e specifikuara në Kodin e Matjes.

**Neni 55**
**Faturimi dhe pagesa**

1. Konsumatorët duhet të paguajnë energjinë elektrike të konsumuar në pajtim me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji apo kushtet tjera kontraktuese të aplikueshme.

2. Kushtet dhe procedurat për faturim, inkasim të faturave, dhe pagesave përcaktohen në Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të nxjerrë nga Rregullatori.

## KAPITULLI X
## RRJEDHAT NDËRKUFITARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**Neni 56**
**Mekanizmi për kompensim ndërmjet operatorëve të sistemit transmetues**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit merr pjesë në mekanizmin ndërkufitar për kompensimin ndërmjet OST-ve të kostove të ndodhura si rezultat i rrjedhave ndërkufitare të energjisë në rrjetin e OST-ve përkatëse.

2. Kompensimi të cilit i referohet në paragrafin 1. të këtij neni do të paguhet nga operatorët e sistemeve kombëtare të transmetimit nga të cilët ka origjinën rrjedha ndërkufitare dhe sistemet tek të cilat përfundon ajo.

3. Pagesat për kompensim do të bëhen në baza të rregullta, brenda një periudhe të caktuar kohore. Përshtatjet ex - post të kompensimeve të paguara do të bëhen kurdo që ato janë të domosdoshme për të pasqyruar si duhet kostot reale.

**Neni 57**
**Menaxhimi i rrjedhave ndërkufitare**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të mundësojë rrjedhat ndërkufitare në rrjetin transmetues të Kosovës në harmoni me Rregullat e Tregut dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilave u nënshtrohet Kosova si nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe kapaciteteve transmetuese të interkonektorëve dhe rrjetit transmetues në tërësi, dhe duke mos rrezikuar furnizimin me energji elektrike.

2. Të gjitha të hyrat e pranuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit që rrjedhin nga shfrytëzimi i interkonektorëve, duhet të shfrytëzohen për të garantuar disponueshmerinë aktuale të kapaciteteve të alokuara dhe të investimeve në rrjet, për të mirëmbajtur apo ngritur kapacitetet e interkonektorëve.

3. Pagesat për qasje në interkonektorë ndahet mes Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe operatorëve të sistemeve tjera nacionale, të cilave u referohet në nenin 44 të këtij ligji, procedurat e miratuara dhe marrëveshjet apo obligimet tjera ndërkombëtare. Këto pagesa nuk do të ndërlidhen me distancën.

4. Nëse të hyrat e pranuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk mund të shfrytëzohen në tërësi në mënyrë efikase për qëllimet e parapara me paragrafin 2. të këtij neni, Rregullatori do të specifikojë vlerën maksimale të këtyre të hyrave që duhet marrë parasysh gjatë miratimit të

metodologjisë për kalkulimin e tarifave të sistemit dhe gjatë vlerësimit të nevojave për modifikim të tarifave. Të gjitha të hyrat e mbetura vendosen në një linjë të ndarë të llogarisë deri në kohën kur mund të shpenzohen për qëllimet e parapara në paragrafin 3. të këtij neni.

5. Procedurat e menaxhimit të kongjestionit do të bazohen në parimet si në vijim:

5.1. problemet në rrjet do të adresohen përmes zgjidhjeve jodiskriminuese të tregut të cilat u japin pjesëmarrësve në treg dhe operatorëve të përfshirë të sistemeve të transmetimit sinjale efikase ekonomike, por preferohet që kjo të bëhet përmes metodave që nuk bazohen në transaksione, metodave që nuk përfshijnë përzgjedhje mes kontratave të pjesëmarrësve individual të tregut;

5.2. procedurat e shkurtimit të transaksioneve do të shfrytëzohen në situata emergjente kur Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të veprojë në mënyrë ekspeditive dhe kur ridispeçimi apo tregtimi i anasjelltë nuk janë të mundshëm. Të gjitha procedurat e tilla do të realizohen në mënyrë jodiskriminuese;

5.3. përveç rasteve të fuqisë madhore, pjesëmarrësit e tregut të cilëve u janë alokuar kapacitete, do të kompensohen për çdo shkurtim;

5.4. kapacitetet maksimale të interkoneksioneve dhe rrjetit të transmetimit që realizojnë rrjedhat ndërkufitare, do të vihen në dispozicion për pjesëmarrësit e tregut, në pajtim me standardet e sigurisë për operim të sigurt të rrjetit;

5.5. pjesëmarrësit e tregut informojnë operatorin e sistemit të transmetimit nëse do të shfrytëzojnë kapacitetet e alokuara, me paralajmërim të arsyeshëm para periudhës përkatëse operative;

5.6. çdo kapacitet i alokuar që nuk do të shfrytëzohet do t'i riatribuohet tregut, në mënyrë të hapur, transparente dhe jodiskriminuese;

5.7. operatori i sistemit të transmetimit, për aq sa është teknikisht e mundshme, do të përcaktojë kapacitetin neto në drejtimin e kundërt të rrjedhave të energjisë në linjën e ngarkuar të interkoneksionit, në mënyrë që të shfrytëzojnë linjën në fjalë në kapacitetin maksimal të saj;

5.8. duke marrë parasysh sigurinë e plotë të rrjetit, transaksionet që lehtësojnë kongjestionin nuk do të refuzohen.

6. Me qëllim të realizimit të shkëmbimit ndërkufitar të energjisë elektrike dhe sigurisë operative të rrjeteve përkatëse, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Tregut dhe/ose të gjitha ndërmarrjet tjera elektroenergjetike përgjegjëse nuk do të diskriminojnë mes kontratave ndërkufitare dhe kontratave kombëtare.

**Neni 58**

**Pagesat për shfrytëzim të rrjetit**

1. Pagesa që Operatori i Sistemit të Transmetimit e aplikon për shfrytëzim të rrjetit duhet të jenë transparente, jodiskriminuese, duke marrë parasysh kërkesat për siguri të rrjetit dhe të reflektojë kostot reale të shkaktuara. Çmimet e tilla nuk duhet të ndërlidhet me distancën.

2. Tarifat që aplikohen për shfrytëzimin e rrjetit nga prodhuesit dhe konsumatorët duhet të marrin parasysh humbjet, mirëmbajtjen e rrjetit, kostot e tjera të operimit, si dhe kostot e investimeve në infrastrukturë.

3. Gjatë përcaktimit të tarifave për shfrytëzim të rrjetit gjithashtu merren parasysh:

3.1. pagesat dhe arkëtimet që rezultojnë nga kompensimi sipas mekanizmit për kompensim ndërmjet operatorëve të sistemeve transmetuese (ndërmjet -OST);

3.2. pagesat dhe arkëtimet aktuale dhe pagesat e pritura për periudhat e ardhshme kohore të vlerësuara mbi bazën e periudhave të kaluara.

4. Tarifat për shfrytëzim te rrjetit, sipas këtij neni, nuk duhet të kenë ndikim në tarifat mbi eksportet dhe importet e deklaruara që rrjedhin nga menaxhimi i kongjestioneve.

5. Nuk aplikohet tarifë e rrjetit në transaksionet individuale për transit të deklaruar të energjisë elektrike.

**Neni 59**
**Informata të rëndësishme për rrjedhat ndërkufitare**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për zhvillimin e një skeme të përgjithshme për llogaritjen e kapacitetit total transmetues dhe margjinën e besueshmërisë së transmetimit, bazuar në karakteristikat elektrike dhe fizike të rrjetit. Operatori i Sistemit të Transmetimit parashtron këtë skemë dhe ndryshimet e mundshme pasuese të saj për aprovim te Rregullatori, si dhe e publikon atë pas aprovimit.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit gjithashtu publikon vlerësimet e përafërta të kapacitetit transmetues në dispozicion për çdo ditë, duke njoftuar për kapacitetin transmetues të rezervuar. Këto vlerësime publikohen në intervale të specifikuara një ditë para ditës së transmetimit dhe përfshijnë, vlerësimet paraprake një javore dhe mujore, si dhe shënimin indikativ të besueshmërisë së pritur të kapacitetit në dispozicion.

3. Rregullatori i siguron Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë apo institucionit tjetër kompetent të gjitha informatat mbi rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike që mund të kërkohen sipas kushteve të marrëveshjeve në fuqi, apo obligimeve në kontekst të Komunitetit të Energjisë.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit zhvillon mekanizma për koordinimin dhe shkëmbimin e informacioneve që garantojnë siguri të sistemit transmetues nga aspekti i menaxhimit të kongjestionit.

**Neni 60**
**Interkonektorët e rinj të rrymës së vazhduar**

1. Interkonektorët e rinj të rrymës së vazhduar dhe çdo rritje e konsiderueshme e kapacitetit të interkonektorëve ekzistues të rrymës së vazhduar, të ndërtuar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kërkesën e investitorit, mund të përjashtohen nga detyrimi për t'i siguruar të drejtë qasje të palëve të treta mbi këtë linjë sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji, nëse plotësohen kushtet si në vijim:

1.1. investimi përmirëson konkurrencën në furnizimin e energjisë elektrike;

1.2. niveli i riskut lidhur me investimin është i tillë, që investimi nuk do të mund të kryhej nëse nuk jepet përjashtimi nga detyrimi për t'i siguruar të drejtë qasje të palëve të treta;

1.3. interkonektori është pronë e një personi, i cili është i ndarë nga pikëpamja ligjore nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

1.4. ndaj përdoruesve të interkonektorit aplikohen pagesa për shfrytëzimin e kapaciteteve të tij;

1.5. asnjë pjesë e kapitalit ose kostove operacionale të interkonektorit, nuk është mbuluar prej ndonjë komponenti tarifash të aplikuara ndaj përdorimit të rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes, të lidhur nga interkonektori;

1.6. përjashtimi nga detyrimi për t'i siguruar të drejtë qasje palëve të treta, nuk dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm apo të tregut të vendit tjetër me të cilin është lidhur interkonektori.

2. Në raste të veçanta, paragrafi 1. i këtij neni, është i zbatueshëm edhe për interkonektorët me rrymë alternative, me kushtin që kostot dhe rreziqet e investimit në fjalë, të jenë veçanërisht të larta krahasuar me kostot dhe rreziqet e hasura normalisht për lidhjen me rrjetin e transmetimit të një vendi fqinj nëpërmjet një interkonektori me rrymë alternative.

3. Përjashtimi mund të përfshijë një pjesë ose të gjithë kapacitetin e interkonektorit të ri ose të kapacitetit shtesë të interkonektorit ekzistues, siç përcaktohet në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Në marrjen e vendimit për dhënien e përjashtimit rast pas rasti dhe në përputhje me vendimin e autoriteteve rregullatore të shteteve të përfshira, vendosen kushte lidhur me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe qasje jodiskriminuese në interkonektor, si dhe mënyrën e funksionimit të interkonektorit gjatë dhe pas periudhës së përjashtimit. Në vendosjen e këtyre kushteve, merren parasysh kapacitetet e reja transmetuese që do të ndërtohen, rritja e kapaciteteve ekzistuese, afatet kohore të projektit dhe rrethanat specifike të vendeve të interesuara. Vendimi mbi përjashtimin, merret në bashkërendim me autoritetet rregullatore të vendeve të përfshira.

5. Para dhënies së përjashtimit, Rregullatori vendos mbi rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve, në marrëveshje të përbashkëta me autoritetin rregullator të vendit të interesuar. Rregullat e menaxhimit të kapaciteteve të kufizuara do të përfshijnë detyrimin e ofrimit të kapaciteteve të papërdorura në treg. Në vlerësimin e kritereve të përcaktuara në nën-paragrafët 1.1.,1.2., dhe 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni, merren parasysh rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve.

6. Kur Rregullatori së bashku me autoritetet rregullatore të vendeve të interesuara, kanë arritur një marrëveshje për vendimin e përjashtimit, brenda gjashtë(6) muajve, ata informojnë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë mbi këtë vendim, i cili në veçanti përmban:

6.1. arsyet mbi bazën e të cilave është dhënë ose refuzuar përjashtimi, përfshirë informacionin financiar që justifikon nevojën për përjashtim;

6.2. analizën e bërë për efektin mbi konkurrencën dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm që rezulton nga dhënia e përjashtimit;

6.3. arsyet për periudhën kohore dhe kapacitetin për të cilin është dhënë përjashtimi;

6.4. rezultatet e procesit të konsultimit të Rregullatorit.

7. Jo më vonë se dy (2) muaj nga dita pasardhëse e marrjes së njoftimit, sipas paragrafit 6. të këtij neni, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të nxjerrë një opinion mbi bazën e të cilit i kërkon Rregullatori të ndryshojë ose të shfuqizojë vendimin për përjashtim. Afati dy(2) mujor mund të zgjatet nëse është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu ky afat mund të zgjatet me pëlqimin e Rregullatorit dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

8. Rregullatori duhet të marrë parasysh opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që rekomandon ndryshimin apo shfuqizimin e vendimit për përjashtim. Në rastet kur vendimi përfundimtar i Rregullatori është i ndryshëm nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Rregullatori duhet të sigurojë e të publikojë së bashku me këtë vendim edhe arsyet mbi të cilat është mbështetur ky vendim.

9. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të marrë vendimin e përjashtimit në rastet kur:

9.1. autoritetet rregullatore të përfshira, nuk arrijnë në një vendim brenda gjashtë(6) muajve nga data e fundit e parashtrimit të kërkesës për përjashtim pranë autoriteteve rregullatore përkatëse;

9.2. mbi bazën e kërkesës së autoriteteve rregullatore të përfshira.

10. Vendimi i përjashtimit, përfshirë dhe çdo kusht të vendosur duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të publikohet.

11. Kushtet dhe procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas dispozitave të këtij neni miratohen me Vendim të Rregullatorit, brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Autorizimi hyn në fuqi me marrjen e gjithë lejeve dhe autorizimeve të nevojshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndërtimin e linjës, përfshirë të drejtat mbi titullin e truallit të nevojshëm ku do të ndërtohet linja.

12. Pas periudhës së përjashtimit, nëse pronari nuk do që të përdorë linjën e interkoneksionit në regjimin e qasjes së lirë ndaj palëve të treta sipas rregullave dhe kërkesave që rregullojnë funksionimin e rrjetit kombëtar, fillimisht i ofron të drejtën e blerjes për vlerën kontabël të mbetur të asetit, për pjesën e ndodhur brenda territorit kombëtar, Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit, refuzon ofertën, atëherë pronari, duke respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin e Rregullatorit sipas paragrafit 11. të këtij neni, mund të ofrojë shitjen e aseteve që gjenden brenda territorit të vendit ndaj palëve të treta, të cilat do të përdorin linjën në përputhje me rregullat dhe kërkesat që rregullojnë veprimtarinë e rrjetit kombëtar të transmetimit.

## KAPITULLI XI
## DISPOZITAT KALIMTARE, NDËSHKIMORE, TË VEÇANTA DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 61
### Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike

1. Për veprat penale që ndërlidhen në mënyrë specifike me vjedhjen e energjisë elektrike, manipulimin e pajisjeve matëse të energjisë elektrike, anashkalimin e pajisjeve matëse të energjisë elektrike dhe kyçjen ose rikyçjen në mënyrë të paautorizuar në një furnizim të energjisë elektrike që transmetohet përmes një sistemi të transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike zbatohen dispozitat si në vijim:

1.1. çdo person që merr, përdorë, devijon, shfrytëzon, nxjerrë, ose përfiton nga energjia elektrike, e cila furnizohet përmes rrjetit të transmetimit, ose shpërndarjes, pa lejen ose autorizimin e furnizuesit të autorizuar dënohet me gjobë ose burgim,sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

1.2. çdo person i cili lidhet ose rilidhet në një rrjet të transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike përmes çfarëdo mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe për çfarëdo qëllimi pa lejen ose autorizimin e furnizuesit përkatës dënohet me gjobë ose me burgim sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

1.3. çdo person i cili lejon që një lidhje ose rilidhje e paautorizuar në një rrjet të transmetimit ose shpërndarjes që gjendet në pronën e cila është në posedim, pronësi apo kontroll të tij ose kushdo që mundëson lidhjen apo rilidhjen e paautorizuar në një rrjet të transmetimit, apo shpërndarjes në pronën e cila është në posedim, pronësi, apo kontroll të tij dhe që nuk e njofton menjëherë furnizuesin e autorizuar për ekzistimin e kësaj lidhjeje ose rilidhje të paautorizuar dënohet me gjobë dhe burgim sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

1.4. çdo person që ndryshon çfarëdo njehsori që përdoret për matjen e sasisë së energjisë elektrike me të cilin është furnizuar cilido objekt nga furnizuesi i autorizuar, ose e pengon njehsorin e tillë apo matësin nga regjistrimi i saktë i sasisë së energjisë elektrike të shpenzuar dënohet me gjobë ose me burgim sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Për qëllime të këtij paragrafi, ndërhyrja në një pajisje matëse ose në matjen e energjisë elektrike përfshin, por nuk kufizohet vetëm në veprat në vijim:

1.4.1. manipulimi i pajisjes matëse;

1.4.2. largimi i paautorizuar ose dëmtimi i një vule apo blombe zyrtare të vendosur në pajisjen matëse nga një person i autorizuar me qëllim të sigurimit të njehsorit;

1.4.3. instalimi apo përdorimi i një pajisje matëse të manipuluar;

1.4.4. instalimi apo përdorimi i një transformatori të manipuluar të rrymës;

1.4.5. manipulimi, ndryshimi ose anashkalimi i një transformatori të rrymës ose transformatorit të voltazhit tensionit;

1.4.6. dëmtimi ose ndryshimi i paautorizuar i modelit, funksionimit, performancës, ndërtimit të çfarëdo pajisje matëse ose matje; dhe

1.4.7. instalimi ose përdorimi i çfarëdo pajisje ose metode tjetër që ndërhyn me regjistrimin, kalibrimin ose matjen e saktë dhe/ose të rregullt të energjisë elektrike.

1.5. për ndjekjen e veprës penale që përcaktohet në nën-paragrafin 1.4. të këtij neni posedimi i mjeteve artificiale të cilat përdoren për të shkaktuar ndryshime në regjistrin e njehsorit ose ndërhyrje në njehsor për ta ndalur regjistrimin e saktë, konsiderohet dëshmi e mjaftueshme se ndryshimi apo ndalimi është kryer me dashje nga personi, i cili ka në përkujdesje apo në kontroll njehsorin;

1.6. çdo person i cili lejon që një pajisje matëse e manipuluar ose anashkaluar të ekzistojë ose të furnizojë me energji elektrike të pamatur ose të matur në mënyrë të parregullt në pronën që është në posedim, pronësi ose kontroll të tij dhe që nuk e njofton menjëherë furnizuesin përkatës për ekzistimin e kësaj pajisje matëse të manipuluar ose të anashkaluar dënohet me gjobë dhe burgim siç është përcaktuar në nën-paragrafin 1.7. të këtij neni;

1.7. çdo person që pengon, sulmon ose merr pjesë në një grup që pengon ose sulmon një person i cili kryen detyrën e tij dhe është i punësuar ose i angazhuar nga një subjekt i licencuar për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen ose furnizimin e energjisë elektrike dënohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Penal të Republikës së Kosovës;

1.8. çdo person që ofron çfarëdo ndihme ose që inkurajon një person tjetër në kryerjen e veprave penale të përcaktuara në këtë nen dënohet me një gjobë dhe burgim siç është përcaktuar në nën paragrafin 1.7. të këtij neni.

2. Kur një vepër penale e përcaktuar në këtë nen është kryer nga një organizatë që është person juridik ose çfarëdo lloj organizate tjetër që ka zyrtarë, organizata dhe secili zyrtar i kësaj organizate do të konsiderohet fajtor për kryerjen e asaj vepre penale, me përjashtim në rastet e parapara në paragrafin 4. të këtij neni.

3. Kur një vepër penale e përcaktuar në këtë nen është kryer nga një organizatë që është ortakëri, organizata dhe çdo person fizik i cili është ortak ose i cili është zyrtar i një ortaku do të konsiderohet fajtor për kryerjen e asaj vepre penale, me përjashtim në rastet e parapara në paragrafin 4. të këtij neni

4. Pavarësisht nga paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni, një person fizik nuk do t'i nënshtrohet asnjë dënimi nëse ai person dëshmon se vepra penale është kryer pa dijeninë e tij ose se ai/ajo ka bërë përpjekje maksimale për të parandaluar kryerjen e veprës penale.

5. Ndjekja penale e një vepre penale të përcaktuar në këtë nen iniciohet pas dorëzimit të një propozimi nga furnizuesi përkatës në prokurorinë publike në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale.

6. Gjobat dhe dënimet e përcaktuara në këtë nen shqiptohen dhe vendosen si vijon:

6.1. për zyrtarët, dhe ortakët e një personi juridik ose një organizate tjetër dhe për personat e tjerë fizik; shkelja për herë të parë pesëqind (500) euro; shkelja për herë

të dytë dymijë (2.000) euro; shkeljet për çdo herë tjetër pas shkeljes së dytë pesëmijë (5.000) euro, dhe me burg sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

6.2. për personat juridik ose organizatat tjera shkelja për herë të parë pesëmijë (5.000) euro; shkelja për herë të dytë njëzetmijë (20.000) euro; shkeljet për çdo herë tjetër pas shkeljes së dytë pesëdhjetëmijë (50.000) euro.

**Neni 62**

**Dispozitat kalimtare**

1. Të gjitha aktet nënligjore të miratuara sipas Ligjit Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike do te harminizohen me këtë ligj brenda nëntë (9) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji , Ministria nxjerrë akte nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

3. Në mungesë të një tregu likuid balancimi i sistemit do të bëhet me tarifa të rregulluara të përcaktuara nga Rregullatori sipas procedurave për përcaktimin e çmimit të jobalancit.

4. Për periudhën derisa të themelohet tregu i shërbimeve ndihmëse, sipas nenit 26 të këtij ligji, kushtet dhe çmimet e ofrimit të tyre përcaktohen me metodologjinë për caktimin e çmimeve dhe kushteve tjera për ofrimin e shërbimeve ndihmëse me çmime të rregulluara. Kjo metodologji përgatitet nga Operatori i Tregut në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe i parashtrohet për miratim Rregullatorit. Operatori i Sistemit të Transmetimit i raporton Rregullatorit për kontratat e lidhura, për ofrimin e shërbimeve ndihmëse, me ofruesit e atyre shërbimeve dhe realizimit të atyre kontratave në baza mujore.

5. Gjatë periudhës kur Operatori i Sistemit të Transmetimit do të operojë si një ndërmarrje e përbashkët me Operatorin e Tregut mund të delegojë funksionet e tij tregtare te Operatori i Tregut.

6. Derisa të arrihen kushtet e një tregu funksional të energjisë elektrike, prodhuesi duhet të ofrojë shërbime ndihmëse dhe të balancimit në kushte të rregulluara në përputhje me procedurat e miratuara nga Rregullatori.

7. Furnizuesve të cilëve u ngarkohet obligimi i shërbimit publik në lidhje me shërbimin universal ose në lidhje me çmimet e furnizimit duhet të mbajnë llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve që furnizohen me çmime të rregulluara dhe atyre që furnizohen me çmime tregu. Furnizuesi duhet të sigurojë që llogaritë e tilla janë të audituara.

8. Derisa në treg ka vetëm një furnizues kompensimi, pagesa e energjisë së prodhuar nga burimet e energjisë së ripërtërishme bëhet sipas tarifave për kompensimin e prodhimit të energjisë elektrike nga këto burime të cilat i mbledh ky furnizues me përjashtim të sasisë për të cilën prodhuesit kanë lidhur kontratë për shitje, sipas dispozitave të këtij ligji.

9. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët aktual të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, përfshirë Kryesuesin, dhe Komisionin e Auditimit, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në përfundimin e mandatit të tyre të rregullt.

## Neni 63
## Dispozita të veçanta

1. Të gjitha kontratat dhe licencat para hyrjes në fuqi të këtij ligji mbesin të pandryshuara deri në përfundimin e tyre.

## Neni 64
## Dispozita shfuqizuese

1. Ky ligj shfuqizon:

1.1. Ligjin Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike;

1.2. Udhëzimin Administrativ Nr.01/2009 mbi përshkrimin e Kushteve për Përcaktimin e Konsumatorëve të Privilegjuar viti 2009;

1.3. Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2009 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2009 mbi përshkrimin e kushteve për përcaktimin e konsumatorëve të privilegjuar për vitin 2009;

1.4. Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2009 për hapjen e tregut të energjisë elektrike për të gjithë konsumatoret jo-familjar;

1.5. Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2008 mbi përshkrimin e kushteve për përcaktimin e grupit të tretë të konsumatorëve të privilegjuar për vitin 2008;

1.6. Udhëzimin Administrativ nr. 01/2007 mbi përshkrimin e kushteve për përcaktimin e konsumatorëve të privilegjuar për vitin 2007;

1.7. Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2006 mbi kushtet për përcaktimin e konsumatorëve të privilegjuar për vitin 2006.

## Neni 65
## Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -085**
**16 qershor 2016**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-026-2016, datë 01.07.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**